

Adem Shkreli

**DRITËHIJET
E JETËS**

**Nga dorëshkrimet e vjetra 1957 – 2003.
Autentike me gjuhë dhe koherencë kur janë
shkruar**

Poezi

Biblioteka



Botues: IWA BOGDANI

Editor Jeton Kelmendi
iwabogdani@gmail.com
www.iwabogdani.org

Redaktor: Engjëll I. Berisha

Radhiti dhe dorëzoi:
Serbeze Shkreli (bashkëshortja)

Adem Shkreli

**DRITËHIJET
E JETËS**

**Nga dorëshkrimet e vjetra 1957 – 2003.
Autentike me gjuhë dhe koherencë kur janë
shkruar**

Poezi



Prishtinë – Brussels,
2024

Poezia dhe jeta në “Dritëhijet e jetës” nga Adem Shkreli

Nga Prof. Jeton Kelmendi PhD

Poezia është streha ku mendimet më të thella dhe emocionet më të fuqishme gjejnë shprehjen e tyre. Në librin e tij me poezi, "**Dritëhijet e jetës**", autori Adem Shkreli na fton në një udhëtim të veçantë përmes valëve dhe stuhiakeve të jetës njerëzore. Ky libër është një përmbledhje e poezive që prekin thellësitë e shpirtit dhe na sjellin në vëmendje kompleksitetin e përvojave që përbëjnë ekzistencën tonë.

Libri me poezi "Stuhitë e Jetës" i poetit Adem Shkreli është një vepër interesante që mbledh një pasuri të rrallë të krijimtarisë së tij nga dorëshkrimet e vjetra, të shkruara midis viteve 1957 – 2003, përgjatë punës së tij dhe nëpër shumë vende e qytete të ndryshme. Kjo përmbledhje na ofron një pasqyrë autentike të evoluimit të mendimit dhe ndjeshmërisë poetike të Shkrelit, duke e ruajtur të pacënuar frymën e kohës kur janë shkruar këto poezi. Ajo përbën një testament të çmuar jo vetëm për dashamirësit e poezisë, por edhe për studiuesit e gjuhës dhe kulturës shqiptare. Me një gjuhë të gjallë dhe të thjeshtë, por gjithmonë të përpunuar dhe të mbushur me ndjenjë, Shkreli shfaq mjeshtërinë e tij në përshkrimin e jetës njerëzore dhe sfidave të saj. Secila poezi përçon ndjenjën e kohës kur është shkruar, duke na përcjellur përmes dekadave të ndryshme, duke ruajtur autenticitetin dhe koherencën e stilit dhe gjuhës që ai ka përdorur në momente të caktuara të jetës së tij.

Ky libër, që përmbledh më shumë se katër dekada krijimtari, është një dëshmi e përkushtimit të Shkrelit ndaj artit të fjalës, por edhe ndaj një realiteti shpirtëror dhe historik që ka ndryshuar me kohën. Vargjet e tij janë të thurura me ndjeshmëri të hollë, të ndikuara nga përjetimet personale, ngjarjet historike dhe ndryshimet shoqërore që kanë prekur jetën e tij dhe të popullit të tij. Në secilën poezi ndihet një forcë e veçantë, një zë që reziston ndaj stuhive të kohës dhe kërkon të gjejë kuptimin në trazirat e brendshme dhe të jashtme të botës.

"Dritëhijet e Jetës" nuk është thjesht një përmbledhje poezish, por një dëshmi e një udhëtimit të gjatë krijues, ku Shkreli ruan origjinalitetin dhe koherencën stilistike të veprave të tij të hershme, pa e ndryshuar natyrën e tyre në procesin e përmbledhjes. Përmes kësaj vepre, lexuesit kanë mundësinë të ndiejnë freskinë dhe emocionin që autori ka derdhur në vargjet e tij, duke ruajtur të gjallë frymën dhe gjuhën e periudhave në të cilat janë shkruar. Kjo përmbledhje autentike na sjell një kujtesë të rëndësishme të ndikimit të fortë që koha, vendi dhe përvojat personale kanë në formësimin e një krijimtari të veçantë letrare. Përmes saj, ne mund të shohim jo vetëm stuhitë që autori ka përjetuar, por edhe mënyrën sesi ai ka zgjedhur t'i përballojë dhe t'i shprehë ato përmes vargut poetik. Është për keqardhje që autori nuk është në mesin tonë, tani që po e botojmë këtë libër poetic. Poeti Adem Shkreli, përse ishte gjallë sikur e harroj vetën dhe kujdeej për botimet e Azem Shkrelit i cili ishte vëllai i tij. Këto poezi i ka mbledhur dhe radhitur nga dorëshkrimet zonja e e tij, Serbeze Shkreli, të cilës i shprehim faleminderime.

Nga aspekti përmbajtësor poezitë e Shkrelit janë të gjalla, plot ritëm dhe të mbushura me ndjenja të thella. Përmes një gjuhe të thjeshtë, por të fuqishme, ai arrin të përshkruajë momente të dhimbshme, gëzime të papritura dhe sfida që njeriu përballet gjatë jetës së tij. Titulli "Stuhitë e Jetës" përçon menjëherë idenë e luftës me vështirësitë dhe përplasjet e vazhdueshme të realitetit, por gjithashtu na kujton se, pas çdo stuhie, gjithmonë vjen një qetësi e re, një dritë që shfaqet pas mjegullës.

Çdo poezi në këtë përmbledhje është si një fragment i një rrëfimi më të madh, që përfshin pasionet, ndjenjat dhe reflektimet e autorit mbi jetën dhe njerëzimin. Stuhitë që përshkruhen në këto vargje nuk janë vetëm ato që vijnë nga jashtë, por edhe ato të brendshme, që burojnë nga shqetësimet dhe përplasjet emocionale të qenies. Autori me mjeshtëri i përshkruan këto përvoja, duke krijuar një relacion të thellë me lexuesin. Në këtë libër, lexuesi nuk është vetëm një vëzhgues pasiv i stuhive të tjerëve; ai bëhet një pjesë e tyre, duke ndier çdo furi dhe qetësi që ndjek pas. Poezia e Shkrelit është një pasqyrë ku mund të shohim pjesë të vetvetes, frikërat dhe shpresat tona. Dhe pikërisht në këtë aftësi të tij për të komunikuar ndjenjat më të thella qëndron forca e këtij libri. "Stuhitë e Jetës" është një libër që nuk mund të lihet lehtë mënjanë. Ai të tërheq brenda, të mbështjell me valët e tij dhe të lë të mendosh për fuqinë e jetës dhe për betejat që çdonjëri prej nesh duhet të përballet.

FARËMBARË

Unë e kam bërë timen
sa kam mundur e ditur
në paça pasur ku ta mbjellë
bimën e mbarë, atë farë
në paça gjetur tokën e mirë
nuk lypë hak as dua mëshirë.

Prishtinë, 13.11.2003.

Sa për dijeni...!

Poezitë janë ruajtur në notesin e autorit, Adem Shkreli, tani të ndjerë.

Datojnë nga viti 1957, nëpër vite që sjellin kujtime interesante. Një pasqyrim për krijimtarinë e hershme të autorit, prej plejadës së parë, po ashtu me gjuhë të hershme.

Po i botojmë autentikë, sikur i la autori, me kërkesën dhe radhitjen e bashkëshortes.

Dritëhijet e jetës

1957 – 1972.

ARTISTIT

Jeta ashtë kangë
e, lum ai që këndon mirë
i lum ai që nis dhe e kryen mirë
jeta ashtë kangë.

Jeta ashtë dëshirë,
shpirti asht jetë
me dëshira si lisi me fletë.
Jeta ashtë kanga
- t'u u dridhë si n'ethe –
dhe nisa t'skalisi germat
si bishë e çalë
kur gjurmat len nëpër bore –
'i dorë e fortë, pa pritë,
më la duarthatë:
“Hej, malok i egër,
ti, kungull për ktë s'ké!
Shpëtimi yt â shkopi
dhe shati e sopata -
se ti për tjetër gjâ nuk je!!”

Po, ashtu me mua...
E ti -nxiton me copën e flakës n'dorë
n'synimet tua.

Sa mur i madh na ndá! . . .

O, një vrimëz, n'mujsh, vorrit me m'ia bâ
se shumë dëshiroj me t'pa
n'dorë at flakadân –
ndoshta për s'dek'ni ato rreze
vrazhdsin e fytyrës kanë me ma lá! . . .

Prishtinë, 1959.

NA ...

Na, jemi t'butë
si qingja ...
me t'mirë, kushdo
kafshatën na merr prej goje
na, mikut ja hapim krahnorin
e zemrën ja qesim përpara
urdhno...
Pse jemi t'butë
si qingja.
Por,
na dimë me qenë dhe t'egjër:
si rrfë e vjeshtës!
-Për atë që na prekë nderën
e derën -
na msyn me mëdyshje!

Atëherë, ta din -
pse mos me i thanë,
Vitorja pa sy ka me lanë!

Shkrel, 16 shtator 1957.

TREGIM I TË VERBTIT

Ka shumë mote, pa s'e kam nanën time
ngushëllohem, flyren tue ja vijzue n'kujtime
ndiej ngrohësin e duerve t'sajë
përkdhelë që m'kanë, saherë
dhe zanin, që n'zemër e ruaj si uzdajë.

Mue, m'ankojnë njerëzit...
(I ndiej tue pëshpëritë shumë herë)
-njëmend, jam i mjerë

Me pa s'mund njerëzit as diellin e vendit tim
me shijue bukurit e natyrës,
as sytë me kullotë -
n'trupin e hjedhun t'vashes si përqaftim.

Por, unë jam dhe i lumtun...
harrue tash kam ngjyrën e kuqe
kurr s'kam pa njerz t'pa krena,
foshnje t'shpërthyeme para syve nanës
as fëmij lakuriq, tretë ndër dhena
si hije t'gjalla, pa prind e ship
që për i kafshatë, bukë t'thatë
dorën, me përulje, duhet me shtri...
M'ndieni o njerz: po ju thom dhe një here
unë jam i lumtin dhe i mjër...

Zagorja, Kroaci, Prill 1957.

PRITJE

T' parën lule që pranvera dhuroi
n'buajlim
kputi dora ime, për ty gatoi
kujtim
si agim i ri, që t'bardhen ditë
përsh'net n'shëndrrim
ardhjen tande, o vashë, kam pritë
mall e gëzim
tash, vjollca ka nis po vyshket n'dorë
e vjen tue u tretë
Ndoshta, një copë akull n'krahnor
kot, tash, ende pretë...

Do t'enden shumë pranvera,
Por n'krahnorin t'im,
Kah plorin tërhoqë sa hera
Hallinat, do ti rrej kujtim...

Sloveni, 8 gusht 1957.

SONTE

Sonte - t'verbtit i ke dhanë sy
sonte - t'shurdhtit i ke dhanë vesh,
sonte - memecit i ke dhanë gojë
sonte - hijes sime përkulë mbi tryezë
i ke dhanë shpirt
se m'duhet një njeri, sonte
n'kupën e çudiçme s'bashku me gjerbë.

Prishtinë, nanduer 1959

AKULLNAJET

Po vie juga e dëshiruar me,
santat e akullit po shkrihen që sot
damarët e mpirë po lëshohen ngadalë
ndofta edhe prajsi për lotin e vale
frymëmarrja po pres të kthehet shqim
qoftë e shkuar, ajo sqotë, ai mugëtim
pipat do lartohen e veten kah qielli
nëpër retë e shprishura po e qet syrin dielli
fytyrave të stërkequra do t'u vie kuqimi
ai që përjetoj rrugën e ferrit
ngjyrën e zgërdhimun ia mësoi mire tmerrit
sythat e rinj paçin fat më të mbarë
një lejlek të bardh tani jemi duke e parë.

Prishtinë, gusht 1966.

RRASHTA E DENUEME

Këtu duhema e barotit
gjethet i ka pas molisë
këtu tymi i tij
e ka pasë zëvendsue mjegullën,
këtu e ka ritue tokën
langu i ngrohtë ngjyrëkuq.
Prej këndeje zogj e bisha
kanë pasë braktisë strofuj e fole
dhe askush sot nuk din:
sa murana këtu duhet me ngre?

Tash n' pyllishtën e gjelbrue
malorët kanë gjete një rrashtë
pak mbi tamth zhbirue
sikur pyet:
“Ku doni me m'vorrosë mue”?

Ashti i ruejtun mirë,
i mungojnë vetëm dy dhambë.
Mund të ketë pas 30 vjet
- mjekët kush kanë thane. . .

Derisa vazhdon biseda:
Kush do të ketë qenë pronari i saj
rrashta pret vendimin, n'fierajë.
- Duhet me ditë kujt i ka takue
për kend dhe përse ka liftue. . .

Askush s'din me spjegue –
ku e ka ajo rrashtë vendin e vet?
Ashti i zbardhue motesh - hesht, nuk flet
dhe kot vendimin pret, pret, pret. . .

Sutjeskë, korrik 1968.

KËRCNIM

Po pati fatin e zi
ndonjë luqeburllë e shkretë
e hasi në mua sonte
dru, do ta korisi
emnin e vet . . .
Nesër as grimcat
s'do t'i gjinden dot
mendja ma pret
e kupa kështu
sonte më thotë.

ANDËRR

Demi i zi na dhunoi
sa herë iu tek
e ne
në shpresë moti na shkoi
se vergjinë
kemi për të dekë.

ZOG ZJARRI

Si i thanë krahëprerit
krahëshkrumit
të përhimun

ç'mëkate ngarkoi fatpreri
nga fluturoi
orbitës

edhe sa herë do sythojë
nga prushi
nga hiri

ku shkeli, ç'gaboi
i mallkuari...
e i dëliri

Zoti madhështor, vallë
harroi obligim
një strofull...

flatrimet e amshimit
ku prehen dreqi
e engjulli

e mjera krijesë
mos befas, lindi
shtesë

dëshmitarët e kalimtarët
lavdojnë e mallkojnë
shpendin e truer

Zoti, a dron njerzimi
nga hikja, padrejtësia
nga ahmarrja (krimi)
nga...

Edhe sa here do kallet
rrumcallet
e rilind nga ploha
bulëzot nga hiri
zog trimor martiri

ZHGËNJIM

Kurdo mbolla drandofile
horra vetëm e vetëm ferra
duart i kam të trume
apo përse kështu m'ngjanë
përherë, përhera?. . .

KËSHILLA

Po deshe
me ua nalë zemrën krimbave
ma pare - ngjyje në baltë
ata
gjithçka s'hanë
pra ruaju, lum miku
mos u ofro mjaltë

NË MUA

Paç me e vjellë atë helm
Po mandej, kam drojë
- gjethet do të digjen
dhe pylli do t'më qortojë. . .
paç m'ia ngarkue lumit
le të shkojë me valë,
po mund ngordhin peshqit
e uji i vdekun, pastaj
fajin s'ka me ma falë. . .
Paç ajrit me ia dhanë
ai rrugën e gjatë e ka
dhe botën e gjanë,
e dika mundet me e tretë,
por prapë kam frikë:
fluturat pa krahë
- munden me mbetë. . .

KUSHT

Ndofta është më bukur
të jesh prrua i vogël fillak
ku rrëketë nuk lëshohen në ty
as prrockat e ndyra
dhe mban ngjyrën tënde
sadoqë i lakmon lumit të madh

kur je i ndotë përherë
të vijnë më shumë qortime
sepse më as ngjyrën tënde s'e ke
e të mbetet vetëm emni
tjetër lum je. . .

ME NJERËZ

Kurdo dasmoj
i kërktoj njerëzit
s'mundem kurrë
me gazmua vetëm.

Kurdo pikëllohem
prapë i kërktoj njerëzit
s'mundem dot vetëm
me blua pezmin.

Pak bukuri
pak shëmti
- kokteji im
pa vetmi

T'ISHA . . .

Nuk di përnjëmend
çfarë do bëja me ty
së pari do të gëlltisja
apo do të ruaja, ashtu
vetëm ushqim për sy . . .

Po të hasha së pari herë
për një çast do të ngopesha
po pastaj i varfër
do të jetoja dhe i mjerë

Tani s'di a më kupto
vehu në pozitën time
gjyko, shiko dhe duro.

O, unë pa mohitem njomcinë
unë edhe mizës ia dua të mirën -
vetëm do të përdhelesha...

PREJ ZEMRE NË ZEMËR

Sa afër e sa larg
sa rëndë e sa lehtë
sa idhët e sa ambël
sa ftoftë e sa ngrohtë
sa poshtë e sa lartë
sa errët dhe sa dritë
sa pikëlim e sa gazmend...

Leysin, 7.04.1971.

PYETJE

Dikujt po i duket i vogël ky rruzull
dikujt po i duket pak kafshata e vet
dikujt shprehi i asht ba:

Me vjedhë dije e me zaptua qiej,
dikush kurrë s'pajtohet dot
me qenë tjetërkush
pos n'rolin e luanit:
me shtrëngue nofullat
e me mbjellë frigë
dhe n'gurin e caranit
si dikur -
edhe sot.

Çfarë frejsh vallë
do t'mundemi me u ble,
e turrin kund kemi
me ua pre?
Si kemi vallë
me i urtue
e urtë, urtë
një dëshirë
t'sinqertë
m'e u thanë
rradakeve t'sharbueme:

- Na mjaft kemi bredhë
n'shpindë t'stuhisë
na ia kemi ndie erën barotit

shijen gjakut
e dimë hijen e zisë.
Largohuni shpendkëqij
duam me qetue
se secili n'zemër
bajmë nganjë dangë,
na leni të jetojmë:
mos na ndërpreni lojën
mos na këputni vargun
thurë me lot e kangë.

EMNIM

Drojë se ata që më rrethojnë
do të mbeten pa dhuratat e mia
- me emnat që u takojnë.

Do të dëshirojsha, e dëshirë e marrë
t'ua xhveshi ato lëkura luajsh
dhe të shoh pastaj në shesh
- lepuj e gomarë.

Dhe më doli mire apo keq
derrit t'i them si duhet
e dreqit vetëm
- dreq.

Vetëm këtë dëshirë modeste kam:
ata që ulurojnë e shungullojnë
e mendojnë se rreth tyne sillet bota
paç me i pa si janë
- pa maskota.

Por koha, s'di a do të më premtojë
ta them atë që bluaj në kokë
apo kjo andërr do të mbetet shterpë
vetëm këtë e kam drojë.

HISTORIA E U.S.

Tri here mijtë ikën prej hatullash
tri here pullazi ra poshtë.
tri here micat mbetën pa troll
e gjurmët lan nëpër hirin e valë
tri herë im at, Ujkan Smajli
pështyni duart e rroki sopatën
tri herë, mbi themel zbardhoi pullazi i ri
u betua im at: - i mbrami unë qofsha fli...

Mos ia zini për të keqe tim ati
pse dëshiron ta harrojë historinë
ajo secilën here ia ngarkoi nga një mëkat
e ai më uroi si prindi me tanë dashninë:

Ti, biro, paç rrugë e fat më të mbarë
unë shkurt e vrullshëm jetova
i pashkollë, por mësova
se është barrë e randë të quhesh Shqiptar.

Ruaju histories, në të raft kah dera
se na mashtroi, lavirja, përhera...

VETËM URA

Unë i urrej gardhiqet
edhe qafat e larta
edhe lumenjtë e rrebavtë
edhe telat gjemborë,
edhe çkado që ndanë

Do të ndërtoja ura
dhe skele që bashkojnë
zemrat, racat, ernat
kur anojnë.

Po kjo ashtë vetëm prall
së cilës, as fëmijët s'i besojnë
prandaj rrudhat e mia n'ballë
flasin për ata që din t'i lexojnë

Leysin, 9.04.1971.

HIJE HINI

Orë e qast shikoj orën
e sikur u mësuaka që pret
çastin e dhëndërisë
nuk dijë se a gëzohem
që iu afrova fundit rrugës
apo i ika mërzisë.

Llozanë, me 10.04.1971.

ORTEKU

Toka a të ec nën këmbë?
Fjalën a ta ngatërron gazmimi?
Flakadanin a ta merr shikimi?
A të duket vetja foshnje agimi?

- Në vete çka ndjen, vajzushkë:
E ke Kosovën para duarsh
apo fshehur nën gushë?

...Ndofta tërë rrëmujët në kokë
të pështillen si hoje risie
e s'e din se një ortek i moçëm
rrëknehet kah humnera.

E ora po sjell dhurata
edhe për fisin tënd -
e ditë bardhoshe agojë pa krajata.

Prishtinë, 1972.

KUR TË VDES UNË

Në vend të testamentit
kam vetëm një lutje
kur të vdes unë
ju lutem mos lotoni
por bëni aheng
qeshni e gazmoni.
Qeshnju e gazmoni
përse keni me pasë
kënd të kujtoni:
përse kam me lanë mbas
gjurmët e paçala e pjatën e pastër
ose përse rrugën ua ka lëshue
një njeri që e pat zanë
vendin e huaj
dhe vodhi një emën,
qeshni edhe atëherë
përse gabimi
(ndonëse vonë)
ka me u përmirësue.

Në vend të testamentit
kurdo, ju miq e tjerë
ju që m'doni
një lutje:
herdokurë ajo ditë
ka me përspjetë
prandaj mbi vorrin tim
s'dua të lotoni
po u lus
për - jetë.

TREGTARI

E ruajta si fijen e lartë
e vara ku s'mund e mbërrin
e ngrita tek flenë andrrat
e mëlmeva me dritën e amshimit
e ujita me djersë e lëng kuqlosh
e fsheha nga shikimi i shtrigave
e miklova me dorëbutën e nënës vejushë
e thura me durimin e marimangës
e shita më në fund për tre groshë
e nuk më paguan as ata të gjorë kurrë
e dina mirë edhe vet këtë mashtrim
e kisha dëgjuar përrallën për mirësinë
e besova si fëmija i dëlirë në çudia
e vet më në fund në gërshtë dreqnisht hyna
e fala atë dhuratë që e ndryshku kujdesi
e mur ai që nuk e meritoi dot sot as mot
e dija mirë këtë, por si të rrotulloj botë
e cila është thurë përkundër dëshirës sime
e palla nuk i han për viktimë e thërrime...

Prishtinë, 11.06.1972.

FILLIMI

Vllazën, a na keni harrua neve?
Ndoshta stuhitë e jetës
mbështjellë na kanë n'lamshin e harresës.
Ndoshta,
ku duhet t'ishin muranat tona
tash buron uji...

MASHTRIA

Ta dhashë zemrën, bebëzat, damarët,
ta besova ma shumë se ditës
t'i hapa palët e tana msheftësive të ndryme
se s'dija me kend kam punë.
Tash hiqmu sysh vrik
largohu se s'jam ma as i imi
ik, se edhe luqerbullat
në hasshin në mua sonte
do ta turpnojnë emnin që e bajnë.

MOS ME TË PASË TY

Kur damarëve bredhin gjarpinj
kur kokës më sillen rrufetë
kur nëpër sy mbështillen ortiqet
kur veshët m'i shurdhon gjam e kaut të zi
nuk di çfarë do bajsha, kënga ime
si të mos kisha ty . . .

TI

Kurdo kulshedra na u kanosë
kurdo anija deshi me u fundosë
kurdo zjarri bani me na sosë
kurdo tufani deshi me na rroposë

ti dorën e shtrinë
fuqinë na përtrinë.

Ti mehlem erdhe n'zemra tona derdhe
freski në ajkë vape kurdo na erdhe,
Ylli yt prore
në ballin e prerë
si kandil n'dorë
shkon tue na ndriçua.

Jam kusar
po tregtar
definicionin
as vet
se di mirë
ndoshta
përngjaj n'lypsa
por mëshirë
nuk kërkuj
as mysja.

SMIRË LAKMI

Zoglës imcake
i mjaftojnë tri ditë
për çerdhen e vet.

Madhësitë dimër
as muaji, as viti
s'më mjaftojnë dot.

Furriku im i tjerrun
ma mpinë moshën e djersën
gjersa ia kam dertin shpendit.

BUKURITË E SHËMTUARA

Nuk të gjeta si në pralla
me bukuritë e mrekullitë tua
s'm'u duke i vogël as i madh
s'm'u duke i mjerë as i lumtur
s'm'u duke i errët e as shkëlqyes
unë nuk të pash fare.

Ndoshta ti mua nuk më hetove
s'po të them këtë për ahmarrje
as pse ti dritën s'mund ma kthesh.

Por pse njëmend s'ta pash bukurinë
kur përzihen kaktus e portokaj
atëherë s'di ç'mund të fali shega së bashku.

Pash në ty barkmëdhenj
të cilët pinë me kurtizane
e paguajnë me nënshkrim.

Pash në ty edhe njerëz t'imtë
që lëkuren e vet e bëjnë dredha
për të zgjatur fillin e jetës.

Andaj si të emërtoj Gjenevë
ti ferr e parajsë përnjëherë

Gjenevë, 15.04.1971.

DOLLIA

Kur në teh motesh
na vallëzojnë sytë butësi
e flasim me buzë e gota
- harrojmë për një çast
sa e madhe dhe e vogël
është bota. . .

Me puthje e përqafile
ura prej kepi n'kep
vallë a dëshirojmë
apo dollinë me mashtrime
duam ta maskojmë?

A kujtojmë udhën e kaluar
dhe cakun e nisur kah jemi
a prekim kund, a lidhemi
“Gëzuar, gëzuar
njëri-tjetrit
kur i themi?

Dasmojmë apo vajtojmë
njëmend, kur cakrojmë
shikimet dhe gotat,
a do t'i kemi hapekrahë
zemrat dhe portat
apo si në teatër
vetëm parakalojmë?

LISIT

Bredha malit, reshtas
indiferent ndaj gjithçkafës;
pleqtë e vetmuar, sogjojnë mekur
dhe dyshet e të rinjve. . .

Po ti në qoshe, brehu im
atje ndër kreshtat e Hajlës,
atje ku rremat numrua s'ia kam
drunjve të fisit tënd
atje ku n'a njeh zgafellet
dhe varrezat e rrufesë.

Po tani nuk njihemi dot
unë tëhuaj jam prej lisave
apo ata prej meje . . .

Diçka ka ndodhur
vëreja vetëm sot.

Lubjanë, 21.04.1971.

FENIKSI I RI

*(Ferid Grezdës të cilin armiku e dogji, me shtëpi,
sikundër edhe të vëllanë, Isanë, në vitet e 40-ta)*

S'na përkundë dot
tehu as shkrumi,
s'na frikësojnë jo
litar, plumbi
poshtë terrori
s'durojmë thundër
- okupatori.

Nuk i shtrohem
t'huajit kurrë
n'rast nevoje
femra trime
tok me mashkull
edhe culli
bëhet – burrë.

Digjen e piqen
varni e vritni
por - urrejtje
t'reja nxitni,
veç të mos thoni
se s'kem ditur,
këtë kurrë -
s'e kam pritur
do të arrij...

po si hakmarrja
e tok me ju
dhe tradhtarëve
plumb e burg
e meritë -marrja

Mbi dënes, dhembje
plagë e lot
e mbi zinë
që mbillni sot,
fort madhështore
do të ngritët
përmendore
- me fitore

Ajo ditë, por
kur të agojë
edhe guri
do të gazmojë,
qyqja gjëmën
do ta ndërpreji
e në vend vajit
zë të këndojë.
Do të marrë krah
që gjithçkafi
do të lulëzojë.
Atëbotë jeta
merr kuptim
... unë po shkoj
peng i lirisë

s'është kiameti
soji im, por
do të jetojë
zot i veti. . .

MASKARADA

M'i kanë ngjitur dhëmbët e ujkut
ma kanë ngarkuar lëkurën e gomarit
m'i kanë mbathur patkoit e demit
ma kanë ngjitur bishtin e dreqit të zi
m'i kanë shartuar kthetrat e korbit
ma kanë mësuar himnin e shpendkeqes
më kanë lyer me peshkve e baltë
m'i kanë qëndisur gishtërinjtë me thumba
më kanë mbjell kaktusin në sy
e çka kam pasur të bukur ma kanë rrëmbyer
pastaj si rregzinën në pluhur më kanë shkrryer
mandej janë betuar në gurë e në dru
se unë rrënjë nuk kam as pip, por kërcu
era më ka sjell prej anësh të paditura
si vepron përherë me thneglat e mitura
e si kloun i dehur jam hedhur në argëtime
në dasmën e huaj e në gjëmën time
përpëlitur jam në dënesë, ankth e rënkime
tash soji im i nemur do të shuhet fare
po qëndroi, ndonëse e grisur, lëkura mundqare
frye tufani i ri, apo kimen e lozi kau i zi
një erë e re nisi të sjelli dika fre freski
atje në horizont si pishaku në pyll
në agun e vonuar nis bardhon një yll
dhe pres të rritet me dritën të na prarojë
thur shpresa të bardha: fisi im do jetojë
futën e farfluar, si i ka hije sojit tim
do të lozi vallen e jetës në hare e përgëzim.

Lublanë, 29.04.1971.

SHIU, SHIU, SHIU

Shi bie pa ndarë
toka është plasaritur roshku
shi bie pa ndarë
gjoli nuk më ka prekur flokun
shi bie pa ndarë
buzët më janë brymuar etje
shi bie pa ndarë
ethe droje më përshkojnë shtatin
shi bie pa ndarë
kokrrat e misrit u dogjën
shi bie pa ndarë
Dukagjinin e ngulshin zapullima
shi bie pa ndarë
patkoit e kuajve kërkojnë buçilla
shi bie pa ndarë
Çetinat lozin lakuriqe si të vrara rrëfeje
shi bie pa ndarë
tereqët mbyten në pluhur byrlykame
shi bie pa ndarë
po orë e ligë e terë e shqim e tretë
shi që bie pa ndarë. . .

Lublanë, 30.04.1971.

PREMTIMI

Fli, fli gjumëmiri i lokes
do të vijë yt at nesër, vokrri im
do të sjellë sheqerka, këpucë të reja do t'sjellë
e do ta sjellë agimin me përçafime
do të vijë me të orkani i pritjes
që e ndryj më vete, vetmitarja
do të vijë me te mëlmesa e jetës,
do të vijë me te rroshku i epshit
do të vijnë me te lotët gazmore
do të vijnë me te ndërresat e palara
do të vijnë me te duart e harruara
do të vijë me te puhia e majit
do të vijë me te duhama e ngrohtë
do të vijë me te nënkresa e djersitur
do të vijnë me te hojet e takimit
do të vijnë me te rrozgat e botës së përrallave
do të vijnë me te përbetimet e dyshimet
do të vijnë me te fjalët e pathëna
do të vijnë me te kojrrilat krahtyer
do të vijnë me te cuklat mashtrimtare
do të vijnë me te drangu e shtylla e shtëpisë
do të vijë me te lejleku i shpresave të mira
fli, fli, gjumëmiri i lokes... ashtu,
fli miralani i nënës, se yt at do të vijë nesër...
e busmi do të përgëzohet, do të dasmojë me ne.

Prishtinë, 2.03.1972.

RITAKIM

Kur ma shtrin dorën pondlani im
më vjen loti dhe ethet me përgëzim
ai nuk di të rrijë evropçe si të tjerët
nuk i ka mësuar rregullat e mirësjelljes
po në thjeshtësinë e vrazhdësinë e tij
unë e hetoj lëbyrjen e syrit miklues
dhe ai e respekton gramatikën mbarë
e nuk më drejtohet në shumës kurrë
rrallë shok, zotëri - asnjëherë
po shkurt: si je - burrë?
Unë i nxitoj atij në grykë.

Evropën e lash pas shpinë
i afrohem Ballkanit,
ndofta ai në stelë më njeh e guri i caranit.
Njerëzit e di se vishen thjesht
dhe nuk janë rritur ende ato shtëpia
e di se më pret pluhuri
rrugët atje janë më të këqija.
Ka më pakë vetura se atje ku isha
por peshën më të madhe do ta kem
njerëzit e mi kanë, si gjithmonë
duart therrake e lëkurëtrasha
po në sytë që vrahen e kthjellen
unë lexoj pak dasma e shumë ndeshtrasha.
Atje, atje tani nxitoj me padurim
atje ku më pret dora e pondlanit tim.

Prishtinë, 2 Mars 1972.

FJALËKRYQI

Profetët lavdërohen se nga lutjet ja nisin fillimin
ne përpëlitemi ta kuptojmë vazhdën e përfundimin
në skenën pikaloshë që përfton më shpejt se reja
mendojmë, se jemi ngjitur tek s'vret kurrë rrufeja
o, rrimë si zogëzat me saçin përherë mbi kokë
nga droja se me një këmbë vetëm jemi mbi tokë
dhe në rolin e djallit apo të vet profetit
ja nxijmë e shëmtojmë ditën vetit e tjetrit
dhe në kotësi të vërtetojmë njëmend fillimin
e zëmë qafën vetë dhe humbim shpejt durimin
nesër, ndofta harrojnë fare se kemi qenë gjallë
aty ku u këput e vazhdojnë atë përrallë.

Prishtinë, 2 mars 1972.

BETOHEM

Ne gjithçka nuk hamë
betohem para teje
se do t'i rrjep yjet
nga stolit shekullore
për hir tëndin
m'i besofshi
fjalës sime
në gjërat e shtrenjta
andaj nuk betohem
në gjërat që kam
pastaj do të gënjejsha
sepse jam aq i varfun
e kam aq pak fyt
sa betim imi
s'do vlente frymë
sepse tërë begatia ime
është mu në gjërat
që nuk i kam dot.

Gradaca, 27 qershor1972.

E KREMTE ËSHTË...

Ditë kremte është e dielli i ashpër
ndërsa një plak, ecën ngadalë rrugës
e miklon kalimtarët me shikim.
Nxjerr nga kosherja qershitë kalaboçe
- dhjet kokrra një dinarë
vallëzjnë tufat kuqloshe
në rrethin e thuprës leverë.
- urdhëroni zotërinj
qershia maji
ju çelin fytyrë
e janë gëzim për fëmijë
urdhëroni, urdhëroni zotërinj...
merri bijë, merri
s'i do, moj vashë?
Kanë ngjyrën e faqeve t'ua.
Merri, se kush han qershie në maj
nuk i bien dhëmbët dot.
Sillet plakushi e durimi
po, kush s'e dëgjon çfarë thotë.
Vallë, prapë sonte i thyer
do kthehet me xhepin zbrazët
e me kosheren plot?

Prishtinë, 26.08.1972.

ECIM

Kur të arrij atje
në skajin tjetër të rrugës
në strofullën e imagjinuar
atëbotë asgjë më
nuk do të ketë vlerë
dhe do të pushojë dihama
e fishkëllim i syrit
do të urtësohet
sepse do ta kuptoj
se s'kam ku tjetër
andaj dëshiroj, udha
të m'i ngrehë veshët ende
dhe të më lidhë
për bishtin e maces
të cilën herë-herë
e ndajë në rrathë drite
para se të përsjeti
në stacionin tim.

Prishtinë, 26.08.1972.

TRADHËTI

Më falni, ju lutem
mos pritni kot,
të mbijnë trëndafila.
Më kishin dhënë
tjetër fare
tani aty nesër
kam drojë
do të thepojnë murrizat.
E di
se faji do të jem bir i imi
prandaj do të mi nxjerrin sytë
në shenjë hakmarrje
e do të lahen para botës
e ajo
do të jenë më e pastër
pa një dorëkeq si unë
e di, e di këtë
Moti.

Prishtinë, gusht 1972.

PO KRIJOJ... PO NDËRTOJ

Mirëkuptim duhet, ore shokë
një farë flame më pështillet në kokë
një projekt kaheër shesto
tash kam nisur të zbatoj
s'ka kuptim që i imi soj
në banesë të huaj të jetoj
pak me mysa e pak me gjysma
vet një vepre unë ia nisa
nëmua hidhërofshi kryet e krofshi
e si qofshi njashtu vofshi
ju me tuajën e unë me timen
nuk ma luan kush dot kimën
kam këto ditë pra do derte
mos më lodhni me koncerte
jo me filma e muzikë
pse ky dell njëherë m'është fik
libra e letra le të qetojnë
më vonë ditë për to agojë
pse kam nisur një punë tjetër
i bëj veti – kryevepër...
Jam i zënë me mur e gur
sa dritare e sa dyer
me çfarë ngjyrë duhet lyer
kah oxhaku e kah çardaku
do të më shteret shqim çanaku
si po sillet ai klinaku...
Ndërsa tjegullat - drenicaku
po llapjani e dibrani

eu sa punët janë ngatërruar
emrin tim e kam harruar
e kam humbur të shkretë busullë
në kokë më parë çati e tullë
sa bëjnë gozhdat sa tavani
sa fasada e trapazani
ani çka duroj qëndroj
pa kulturë unë mund të jetoj
tani di një fjalor tjetër
do ta shihni ju këtë vepër
për lakmi e për zili
qe fitili për komshi
kur të rritet e hazdiset
bacaloku në te kulmoset
shumë i cili do të prek në kokrra
folni ju shkokloni dokrra
unë po merrem me ekonomi
me ndërtim pak me tregti
kështu kokën e pastroj
e fjalorin e pasuroj:
shprehje të reja si i do “feja”
po, një shufër, të bakrit u dashka
se... rrëfeja
mund të koptiset mbi pullaz
e ku e pata... haj, më duhet sopata
po a dini, miq e të tjerë
mos ma bëni ju potere
ca problem kam me derë
me ndërtues, e me saldues
ikni e mos ma shtoni marazin
ende vu s’ia kam pullazin
shkoni ju, kam marrë rrugë tjetër

do ta kryej këtë kryevepër...
s' dua ta tredh mendjen me ju
e të jetoj si qyqe në hu...

DRUA, DAMARËVE TANË

A jemi soji ma i nemur
djale pas djali.
Na ka mallkuar Zoti
apo vet djalli.
Sapo vëllai nis të sythojë
ne ia gatisim hekuraqet
e vegzën për qafë
verbuar nga smira përherë
na kurrë krahun e ndihmës
s'ia japim
pos të shtymes kah humnera
hënën në ballë ne pastë i miri
na do e nxijmë e pështymë me vrer
pale, mos do e shalojmë vet kalin e fatit
dhe kështu shuajmë kandil e fener
e secili nis për veti
Kështjellën e Rozafatit.
Kështu që moti ishte
ëndërrua s'ka gjë as sot
ne as të birin e lokes sonë s'e durojmë
po veten e marrim për Zot.
Dhe sado mbarë merr çapin
na shpejt do ta plandosim
sepse shoshojtë vetëm varre i hapim.
Një yll sa agon në horizont
na nis e gjuajmë me bagla.
O, mos shtrigat janë gurrë vëverri
apo damarëve të fisit tim

në vend gjaku ec qelbi e vreri
mos soji im në këtë ankth
drua, shumë kam droje
përherë do të jetojë...

KEPI I FATIT TË KEQ

Sa herë shkrepën rrufetë
m'u shurdhuan veshët
sytë mu terratisen
m'u shkrumua kripi.

Thonë,
rrufetë prekin lartësira
porse, as kjo urti
për mua kurrë
nuk qe ngushëllim.

HIJE NATE

Më merrni ré endacake
e silluni me mua andej
kah shungullojnë rrufetë
sepse kjo qeta varri
më mbyt shqim
më mirë ndër sqota
se në amulli.

23.06.1972.

KTI I THEM MJEGULLA

Ku i ke gjurmët e kuqe
ku e ke djepin e blertë
ku i ke luleborat herake
ku e ke ylberin e fshehur
kthehu e pshurru ndër lule
dhe bjer e flejë në hithra
që t'i ritojnë damarët.

24.06.1972.

GJOLI

Bie në lumin e madh
lumi detin shqetëson

avullohet ngadalë
bie shi.
E njerëzit bisedojnë
për të reshura atmosferike.. .

KORIDA

Po i zhgulum shtizat një nga një
plagët i lëpijmë me gjuhë
nynykasim lutje të reja
nxituam duke dihatur
besuam në fjalën e sinqertë
në arenë hymë symbyllas.

Po në besimin tonë
u dhunua edhe toka
në demat e marrë
në arenën e dehur
humbëm torruan
e nisëm të pallim
pas toreros së verdhë.

Kur na vranë shikimet
dhe u pëlandosem solemnisht
vërejtëm djallin maje thembre
duke u zgërdhirë hajnisht
na gufoi vreri dhe prekëm
në akull rrotull zemre...

DUELI

Njërit
i duhen shkallët
për t`u ngjitur te kërpudhat.

Tjetri
lëshon dorën poshtë
e mbledhë shegët e vesuara shqim.

Secili
për shujtën tjetër
shoqi shoqit ia kanë lakmi.

PASQYRË

Atje
ne shkojmë
vetëm përherë
e shuajmë etjen në të
apo mendojmë se pastrohemi.

Ai herë
llahtariset keq
apo gati thahet
e peshqit -
ngordhin anash.
Herë është i turbulluar
herë pastër si loti
na pasqyron
lumi
ynë.

THONË

Thonë që moti,
se rrufenë prekin
vetëm në lartësira.
Porse kjo urti
për mua kurrë
nuk qe ngushëllim.

NDODHI

Ky më shumë
ajo si lumë.

Rrumbull, sumbull
Oshtimë, vërshimë.

Hap e hendek
ku jetoni, prek

PADIJA E HIJEVE

Kuqëlimi i agimit
ka ngjye horizontin
agim i mrekullueshëm
sot ka puthë Hiroshimën.

Damarët e tokës ngjallohen
si thneglat mbas gjumit dimëror
shumohen n'levizje piklat
nëpër dejtë e t'përhershmes
me thithë yndyrën
si bleta nektarin lules.

Që kolona fëmijësh
me libra n'dorë
kah n'shkollë nxitojnë hareshëm
pa kujdes jete
me gaz feminos ndër buzë
me tufë pranverash si parzëm
e i det dëshirash n'krahrorin e njomë
dhe adrash t'kandshme rinore.

Tymtari i fabrikës vjell ngulshim
e fytyrat ngjyrë bronzi
përçojnë gaz n'kryqzime shikimesh.

Gjithmonë me një zë trishtues
nën çekanin e rëndë
si ç'donte me kërkua mëshirë

prej duarve therrake
e pikat e njelmëta
numërojnë t'ramet.
Prej gjini tokës reshet ngadalë
rripi i gjatë
dhe mirë dal-
futet tjetra ma e gjatë
vllazen, me fat?
Mbarshtru shpijakja
e gëzueshëm pret t'birin
me peshqit e freskët
që shtratit butë
mundin e natës t'ia fali
- ka mbet pa fjetë
zemra e lokes
është koha me ngranë
n'truyzë mëngjesi e pret

*

Ja korbat e zi ia behin
kalua kanë si dhena
e tash sillen kaltrisë gjanë
me i za kob-ndjellës
dhuratat e para
nis e lëshojnë mbi krena...

*

Vllazën, a jeni tu u kënaqë
vërtet ashtë e bukur loja
me kuklla t'gjalla
madhshtue është loja e njeriut
me epshe t'gufueme

Vllazën

(mos u çuditni pse kështu po u themi
se fryt i një bime jemi
dhe për të njëjtin qëllim
rektuen dhe zemrat tona)

NJË NXANËS:

Sot ngjyrën kam sjellë me vete
dhe pendën, për hartim
“Dashuria e prindërve”
mu s’më ka pëlqye kjo temë
goja s’do s’mundte me nxjerrë një fjalë
prej zemrës së ndrymë
se prehni i nanës herët u ftoh për mua
n’lehonë e mori vdekja
Tash ç’kujtesë ruaj vetëm fytyrën e saj
dhe ninullat që ç’vinë në gjumë
bujshëm si n’mjegullë!

Me shkrua s’do t’kisha dit
as për babën
që s’di kur i pushojnë eshtrat
(dasma e kuqe e përpiu) e vetmia
dyfish na terroi fëmininë.

Si kam me shkrua për vëlla e motër
kur gjurmët s’na dinë
e ndoshta takua i kam njëherë,
o vëlla,
unë kam shkrua
vetëm për babën - njeri
e për nanën: jetë
(kam shkrua për ty)
ani, pse
as emrin s’ta dijë...

(një dorë e regnueme
e njomë, grusht bëri
mbi pullazin e shtëpisë renueme)

NJË PESHKATAR

Kur dalldiset deti
nana, me zemër t'galshue
përpiqet me lurtue valët
me fjalë shejtnije
e prej pragut derës përgjon
me pyet kalimtarët
rishtas mos ka ndo gjë.

Një ditë ç'stuhishme vjeshte
babën tim
e përpin valët e detit
e unë prej bregut
kam shikua memec
varrin e paskajë
barkën e rrëknye mbi fythin e valëve
e i dorë mbi faqe t'ujit
fortas ngjitet për rrjet
e ndëgjua kam shumë fjalë
por s'kam kuptua, vetëm
... jetë, jetë, jetë ...
mjellmat qafëbardha
i banë
nderimin e fundit
e unë u ktheva n'shtëpi
te nana
me kumtin e zi
dhe lot ndër sy.

Valët mbërritën me barkën n'zallë
trup i plandosur me ngjyrë mramori
heshtas me sy t'prishun
e peshqit luajnë vallen e mbrame
n'diellë që t'kallë.

NJË FOSH NJË

Unë as me falë
nuk di si duhet
jam lulëza e njomë
vetëm nanë e babë – fli ma së miri
emrat e tyre m'janë ngri ndër buzë
dhe kukullën time, e dua
or tash nuk e di ku gjendet
e dini,
unë shumë jam kujdesur për te.

LOJA E LUGETËRVE

Ia nisën këngës e valles pa orar
mbi ta thua, përherë rri dielli arë
apostujve u bëjnë aheng që mirësi
të zbres mbi ta sepse në qesëndi
do t'u vetet moti po të vajtojnë
e dhimbën e pezmin vetëm do ta shtojnë.
Andaj këngë, valle, hare dhe mahi
që të iki, orë e ligë dhe freski
të sjellë gazmend ndër enë gjaku
pse kur piqet në kokë prita e laku
s'mund i përthekon ai kungull i mjerë
Orëligë, trishtim, vetëm lot e vrer.
Prandaj, nxitoni, o vallëzues, të harbuar
të keqen me aheng për ta gjunjëzuar
në log u pret vallja e hareja
kur të qaset orëliga le ta mashtroj preja
dhe çdo çast tuajin emërojeni pranverë
mbyteni të keqen me puthje e verë,
e kur të qaset lypsja e sëmurë
do ta trembni keq me eshtër e lëkurë.

Sllloveni, Jezersko, 19.05.1971.

GATI

Ta dhashë zemrën, bebëzat, damarët
të besova ma shumë se ditës së mirë
të hapa dyer e dritare të qenies sime
vlimet e mashtrimet e tanë fshehtësitë
t'i fala krahët që kapërthejnë largësitë
s'e dija fare se me kënd kam punë
s'e dija se po ushqej hienën edhe unë
e cila nesër do t'm'gëlltisi në shenj mirënjohje
qesh gati me përgëzim t'i shkrijë akullnajat
qesh gati me dorë t'i zbus gjembat therakë
qesh gati me shikim t'i luftoj gjarpinjtë
qesh gati të bëhem gurrë për eliksirin e kuq
çka të dhashë more çka ruajta - vodhe
nuk di a u ngope, po tani kur s'u lodhe
dora jote nuk di çka ofron e premtion
fjala e ëmbël... po n'kokë çka vlon?
Unë të fali, ti po kërkon ndjesë
por, tani si, ma thuaj, si të lidhi për besë
mbeta si dru i vetmuar, çka fali e shes.

PA STROFULL

Si zogj të trembur rrebeshesh
keni marrë dhen në sy
e u sjellë poshtë e lartë luhaja
po në vete dryni dëshirën
që të ktheni ndër troje
e gjallë u mban uzdaja.
Kur takoheni herë-pas-herë
faleni, putheni dhe qani
mbushur pezëm e mall, të mjerë.
Mërzitur me bukën e lypësve
rriteni dhe plakeni
kështu me ëndralla
me mahi, nga pakë e si në përralla
u sjellë vërvitur
gjersa një ditë
pa arritur në stacionin e blertë
rastësisht u merr dheu...

Laussane, 11.04.1971.

MOTËRZIM

Toka,
a të ec nën këmbë?
Fjalën,
a ta ngatërron gazmimi?
Flakadan,
a ta kap dot shikimi?
Vetja,
a të duket foshnje agimi?
Çka,
apo çka po ndjen vajzushë?
Kosovën,
para duarsh apo nën gushë?
Ndofta,
si hoje risie në kokë
Përftojnë
ato xixa e të ngulshojnë tok
E vrikesh
në një botë krejt tjetër
E s'di
se rrëknehet orteku i vjetër
Kapton,
Furishëm kah qafëtheja
E bulëzojnë
për fisin tënd agime të reja.
Premtime
urime, motër, urime...

Prishtinë, 25,05,1971.

ULKOJA

M'i përngjanë tokës së plasaritur
e cila në vapën e verës pret shiun
sillesh vërdallë rreth vetes
edhe profetëve do të dëshirojnë
t'u fusin fitilin e zhgënjimit
secila pore lëkure fton
llahtarshëm, si ushujza
si hienë e untuar
që i qaset presë
nga sytë pikon lakmia
e në kraharor digjet zjarrmia
e kur prek në indin e Amorit
atëbotë, fillon loja mashtruese
pse ti i koptisesh Mont Everestit
e do që ta mbulosh lavën
me rrobat e Arktikut
e ngritë sedrën rrenacake
ndër qiej e diej
ku nuk prek dorë e askujt
e nis prapë kështu rrita jote
për t'u gjunjëzuar nesër para veti
e u shpërlla me lotët e pendimit
po pra edhe njëqind herë
do të kapesh në këtë valle
gjersa një ditë e stërkequr
kur të kthej muzgu yt
të mos mbetesh pre qeni.

Prishtinë, 1972.

QETËSI!

Me mua nuk di ç'po ndodh
mos rrasur është satana
e tani dërmon kraharorin
si dem i trenuar keq!

Apo çfarë lozë kështu
në kokën time të vogël
ku s'ka vend për tëra të zezat
e vogla e të mëdha të botës.

Nuk di, a ka gjasë
të prajë më kjo furtunë
dhe kungulli të pëlcasë
le të dihet - edhe kjo punë...

Leysin (Zvicër), 7.04.1971.

NUK JE VETËM

Ti s'je vetëm, motër e lotit
që marrë e ke botën në sy
për kafshatë buke
shqelmuar prej njeriut e Zotit.
E shoh, këmbët nuk të mbajnë dot
po pip rri para zotërisë
gjersa ai zgjedhë, urdhëra
dhe han ngadalë e pi.
Të dhemb e digjet koka
po të keqen në veti e bluan
dhe ankimin tënd e han toka.
Padroni, motër e panjohur, e mirë
sokllon me sy e bën me kokë
dhe lëkurën do ta shiste për para
e mos prit nga ai mëshirë.
Po mbaju edhe ndonjë ditë, duro, qëndro
e mos t'agoft, pastaj si gardh i kalbur
zbrit e shkarkoi poshtë eshtra e brenga
dhe pusho, pusho e pusho...

Llozanë, 9.04.1971.

URTIA

Bie shi i mirë
rrit bimë e jetë
po mbi mua përherë
gurë e shigjetë.

Pres frytin nën dardhë
e shtroj tryezën e bardhë
po pikojnë para meje
thanat e murrizat.

Mbjellë portokaj
kur vjen pranverë
po në të vjela
piqen kulumrijat
e kështu dhëmbët e mpirë
i kamë përherë.

Prishtinë, 1972.

NDARJE

Ndoshta do të vije dita
në syrin tënd të bukur, Eva.
Po mos u shqetëso, njomcë
se ke një dritë tjetër
që i vlen dy sytë...
Mos u përlosh tani
kur përshëndetemi si memecë
dhe mos ngarko barrët
që shpirti yt s'bën dot
nesër mund të jetë më keq
andej ditës e gjithçkafes
si fëmija lodrës së re
qeshju e gëzoju sot.

Leysin, 29.03.1971.

GËZIMI I GËZIMIT

Sytë të vezullonin shkëlqim, shkëlqim
kur provoje, si fëmija lodrën, shikimin tim.

E dija kur qaje me lot gazmendi
dhe luteshe, për mua, luteshe pa ndarë
duke u lëkundur pezëm nga vendi
shifsha dritë tim në sytë tu zvarrë.

Po erdhi terratisja e gazmendi s'zgjati shumë
tani përpëlitem si peshku në të cekëtin lum.

Tani ndoshta veten e ty mashtroj me premtime
po gjerba jote, është imja, Nusha ime Nusha ime.

Prishtinë, 17.02.1971.

ÇAST DËLIRSIJE

Nuk jam mësuar kurrë
të sogjoj nga lart
nga caku i zogut
por as nga caku i zhabës
rregëzinën e respektoj
por s'e dua pozitën e saj
dhe sa mund të qëndroj
do të bajë, do të bajë.
Po në marrsha kah humnera
ku s'ka grep as dorën
s'të shtrin as era
më parë do t'ia qëndisi veti ballin
në mos mundsha ta pres
vdekjen në këmbë
në mos mundsha ta kafshoj
tigrin me dhëmbë..

AS TI

As ti gjithmonë
nuk më dole besnike.
Unë jam i gjykuar
të udhëtoj përherë vetëm
pse kur bie nata
e s'ka dritë as fanar
dhe ditën pa diell
shikoj para e pas
sillem rreth veti
e ti s'je askund.
Tradhtia ime
po ku të mbështetëm unë.
As ti gjithmonë
nuk më je besnike
unë jam i gjykuar
të udhëtoj përherë vetëm.
Tani më nevrikos edhe mësimi
i atij plaku të panjohur
i cili kishte thënë dikur -
se njeriu ka përcjellëse
vetëm hijen e vet kurdo.

Llozanë, 14.04.1971.

Dritëhijet e jetës

1975 – 1999.

SI

Kur jam larg teje
kur e zë akulli më prek gjoksin
kur t'afrohem ty
-më përcëllon flaka syve.

Prishtinë, 9.07.1975.

DJE DHE SOT

Dje qielli
ishte më bujar
dje thekte verri
po bënte ngrohtë.

Sot një ditë pas
jam më i rëndë
sot një ditë më vonë
jam aq i moçmuar
sa gjymtyrët e mpirë
nuk dëgjojnë dot
sepse me veti mori
ngjyrën e zjarrtë flakuese.

PERFTIMUR

Oj, gocë e pa emër
le të merr soj i djallit
por edhe mua, veçse pa ty.
Tani në sytë e terruar
kushedi e cila sot
vërdallë nëpër rradake
si dhi e egër
porsi ato këmbë fistrojka
të primë dyerve, e zemëruar
licitore, herë-herë, tredhore
gjersa mishit e vrugnuar
lemeritë e vyshket një ditë

Sofje, 5.05.1973.

PËRRALLË TERRI

Sonte dallëndyshet e metalta
kanë dalluar çerdhesh shqim
e lëpijnë gjurmët e zbraza
me ankthin e tyre në shqetësim.

Sonte fundin ku e ka nata
vallë, orët përftuese ose të gjata
mikeshat e dashura, bukuroshet e territ
ia kanë marr çelësat parajsës e ferrit.

Engjëjt oreolet i kanë grisur
ose çfarë po ngjet me të krisur
pësjtjellcin larak të botës
në vithe të rrotofojkës.

E kërkova, kot e kërkova
dhe sado që e gjeta
s'arrita dot, e nxitova
ma mori frymën tatëpjeta.

Zagreb, 15.10.1975.

VIZA IME

Në sy ia urtova shikimin
ia shkruva në bebëza guximin
tash s'më leh dot ore e çast
unë rrugës sime, - ai vjen pas.

ËSHTË...E S' ËSHTË...

Është një erë e është një frymë
është një vesë e është një brymë
është një ditë e është një dritë
është një shteg e është një pritë
është një hoje që i del gojë
është një shpend që s'di për troje
është një bringë e është një mall
është një zjarr që kurdo të kallë
është një maj ndër ograhe
është një vërri që ruan shullaje
është një qiell që s'di për diell
është një bukë që s'bën pa miell
është një kep e është një thep
është një kumt që shtangë e step
është një dorë që merr, që jep
është një foshnjë që s'njuh djep
është një teh që pret e rrjep
është një plumb që pushon në cep
është një rrëfe e shungullimë
është një shufër e një vetëtimë
është livadh, është një rudinë
është një grindje, është një lindje
është një prekje, e ftoftë akuj, vdekje
është një fjalë e është një hale
Është një shtrigë, është një e ligë
është agimi, është dhe shpëtimi
është mugëtira, është errësira

është plot syri është shkretëtira
është dorëbuta, ftoni e fiku
është sedefi e është çeliku
është një lum e është një det
është anije që s'pret
është një cub që gjuan e s'vret
është një sy që s'ka të kotur
është një gojë që s'di të ngopur
është një dorë që yjet vjedh
është një gisht që shekujt mbledh
është një sqotë valltare n'botë
është një nuskë - zemra ta thotë
është një shpat sketer e naltë
është një stinë vetëm shtrëngatë
është kufomë, është një lugatë
është një gëverr e është një ferr
është një drapër – këput e herr
është një gotë - plot pelim
është gerçamë që duam shqim
është një enë e mbushur mjaltë
është një faqe e lyer me baltë
është një nënë po është dhe njerjë
është pra gjarpër e është një nepërkë
është e s'është po një e vërtetë
është dashnorja e quajtur jetë.

Split, 25.01.1976.

VETËM, GURË

Në vend të fluturave
ai ndiqte hijet
vente kurth
e hapte varre.
Ndonëse epiteti mëson
vetëm fjalëmirën
për të vdekurin
kjo s' vlen për atë.

Andaj
kur t'i veni te varri
lulet do t'u digjen në dorë
dhe as bagla ruse u çoni
në kotecin e tij
se mund të mbijë prej tyre
bari dhe lulet . . .

KURRGJË NUK MORI TOKA

Kurrgjë nuk mbeti pa u ditur
tëra fshehtësitë mbeten në log
anipse për një çast dikujt iu mur zëri
anipse dikujt iu rrudhë gishti tregues
anipse dikujt iu mjegullisë shikimi
anipse njëherë diku shurdhoi murrilani
asgjë mbi tokë as nën te kurrë deri në fund
s'e mbuloi shtreza e rrotullës sonë të larme
askush nuk u ngjiti maje Olimpiti aq lehtë
pa i rënë jargët gjerë në brez si rrëshirë
askush kaun e zi s'e kapi për veshi
pa i lënë gjurmët pas, sado bukur i trinoi
ne mashtrohemi vetëm, ashtu, si ëndërr
na bëhet se tërë gjërat përftojnë qetas
dhe kalorësit gaztorë ndërrojnë stolitë
e tërë të bërat i merr rrethatorja kaliboç
e ata kopsiten më tej, engjëjt e padjallëzuar
por kot ushqejmë këtë shpresë, të dehur ëndjesh
se asgjë nga të paditurit toka me veti s'i mori
vetëm mund të mashtrohemi për një çast...
pastaj, gishti, fryma, zëri, shikimi, murrilani
kurrë nuk mundëm t'i ikim lëvozhgës sonë
gjerë në fund, se toka e pabesë, na tradhtoi.

Prishtinë, 23.12.1977.

NËSE...

Në ta lëshoftë fjalën goja ime
n'u bëftë shufër gjuha ime
n'u shurdhoptë veshi im
mos pastë rrudhë në ballin tim
- merre shpejt atë kungull t'gjorë
varr shqim mbi hu murrizi
vene në kopsht trumaç shpezësh
t' mos rrëmbejë mbi qafë bllok
Ajo rreze që veç gëlltitë

Prishtinë, 24.10.1977.

SHTEGTIM

Kurdo u faisën kokat
trualli im shtatzënë
e dita prapë - lehonë
ma fali rrugëmadhen.
Biografinë time cuklane
ma ruan balli
si hija të zanë.

Në myshkun verdhok
kanë ra në fushë ditët e gurëzuara
e tej horizontit citojnë kujtimet
tani pres
me dëlirë krepin ngadalë.

Prishtinë, Tetor 1977.

ELEGJIKE

T'i lyrë e thyer
që e shurdhove veten,
kur e ke dasmën
që të këndojmë tok
njëherë për ty.

LAKMI

Kur i malliset luadhit
e i pret fijet e buta të barit
pastaj ndër gjellën kripën
e lëpin, gjersa e kuqëlon token
dhe i turret kroit a gurrës
e prapë lëshohet ndër curra
hej, rërë bota e tij është
lum dashi fatbardhë
lakmi ia kam nganjëherë
përse kur këto i ka përpara
kurrjë tjetër për të
nuk ka qëllim sa vlerë
e si të mos i lakmoj fatbardhit
që i frikësohet vetëm bariut
e ia ka dron gardhit?

Prishtinë, 9.08.1977.

RROTULL

Mbeti varur mes Djallit e Zotit, si pehajë.
I thane: - Pak të mori Zoti, nuk të dënoi.
Merri ato dhunti: ha, pi, rritu e jeto
dhe ndriço rrugën andej kah shigjeta të mëson!
- Jo, të mashtruan - i thanë, t'i morën të gjitha i gjorë...
Nxitoi te Zoti, djersitur e ngulshuar,
mandej te Djalli për sqarime të reja.
U soll si rrotofojka e mori malin.
Kush e mashtroi, rrezen kush ia mori?
E mësuan: - Djalli ta mori frymën, o mendjebjerrë,
Prandaj prit derisa të vijnë këmbët e reja!
Ky vrapoi e vrapoi derisa humbi sytë ndër hitha,
nxitoi derisa iu bë truri hirrë vërrini;
kërkoi shtëpinë që se kishte pasur kurrë
mes Zotit e Djallit, në garën e përhimët,
kah nuk hyri e nuk doli, i gjykuari
derisa iu kalb gjuha në lutje amshimi,
derisa i pëlciti urtia e vegoi durimi.
Mandej e mori mjegulla krahëlehtë,
baladën ia shkruan përroskat e moçaleve,
varrin ia zbukuruan thneglat e i bënë uratën.
- I lumi! – thanë vëllezërit e tij -
mori udhën e qiellit, kur ai u përjarg si foshnje
e belbëzoi diçka të pakuptimtë...

KOT U BETOVA

Merreni kokën time
rrasur majë hunit
në bisht lagraçë
ngulur mes shullërit
korbave ftingë,
që këtij të mos qasen
e ta kokrrojnë
farën e ligë.

Merreni pa u dhimbtë e drojë
po s'vlejt më shumë,
lidhjani, pas një tojë
e hidheni në lumë
me valët le të kaptojë
ose le të helmojë
kuçedrat e përrallave
po s'vlejt më shumë.

BARRË E MARRË

Kurdo u koptisëm në pyll
unë e gomari tok
pandeha të kthehem kaluar.

Dhe secilën herë
ai u kthye në trok
e unë i ngarkuar.

Kot gërshetova
kot u betova
të mos e përsëris kurrë më gabimin
në të parin rast e shkela vendimin.

ASGJË ME HIJENËN

Asgjë nuk bëre me hienën
po ia ndërrove vetëm emrin.
Asaj i mbetet nuhatja
dhe vesi i mësuar moti

Ajo prapë do të bredhë
do të përcjellë korbat
dhe prenë e mbetur...

Lyhet si shtihamë nate
e pret çastin e gostisë.
Asgjë nuk bëre me hijenën
po ia ndërrove vetëm emrin
e ia fale një lëkurë të re
- asaj i mbetet nuhatja
dhe vesi i vjetër...

ARRATIA

Ia behën shqim
pluhuri,
zhurma,
metali,
tymi.

Ata, si kope e lidhur
morën male,
e gjethe
e dritë
qetësi.

Lan prapset e veta
dhe çerdhet
e pendlat
me glaca
kujtim.

Vetëm njeriu trim
mbeti në fron
pa stolinë e tyre
e cicërimën
bukurinë.

Tani me kokëfortësi
pa zog e flutur
qëndron,
e punon
gropon...

DASH DRAGOI

Kur mullisët luadhit
e pret fijet e buta të barit,
pastaj kripën ndër gjolla
e lëpin, gjersa e kuqëlon token
dhe i turret përroit e kroit
e lëshohet prapë ndër curra
e kap bokën tatëpjetë
tërë bota është e tij, hej
lum dashi fatbardhë!

Shpesh ia kam lakmi,
përse kur këto i ka përpara
për të kurrgjë tjetër
nuk ka më vlerë,
e s'i prin dot tjetër qëllim -
vetëm gardhi e pengon të hyjë arave
dhe bariu, në të rrallë
kur e them në mallim...

Nis e cak
gjak e lak:
barë o sane
dhe kripë e ujë
- kurrgjë kurrkujt...

KUT E QYP

Qeni i çartur
kurdo është i ndërsyer
me shkas e pa shkas
(e di mirëfilli se heshtas, një ditë)
mund të ma ngjeshi
nga pas. . .

Por do të duroj
gjysmë dhembje
pse kurrë -
nuk i lëbyr sytë butë
e s'e ndolla dot:
kut, kut, kut...
Do të më ngeli ngushëllim
vetëm qëndrimi im:
kurdo i thashë - qyp!
Kështu e bëra timen
e ai të veten, le ta bëjë
si të dojë - qimen. . .

Prishtinë, 1978.

GURË I VAKTË

*Kush fluturon lartë e lartë
retë ia përcëllojnë flatrat.*

Afrohem dhe sogjoj fytyrën e dylltë
së cilës moti i ka ikur gjaku
po ende fshehët në te diçka engjëllore
thujse tani do të shkrep buzagazi
kur i qasem atij fronti të përmorët
sikur më djeg diç e njelmët
dhe shqim iki nga kullë e mermertë
por afër a larg kurdoherë
kur përmendet emër i tij
i ngjaj një fanatiku të përbetuar
dhe sikur bëhem nga pakë religjioz
- nuk mundem pa u lëkundur vendit
i gjallë a i vdekur ai ishte i madh
dhe atë dhuratë e mori me veti trashëgim.

Sofje, Janar 1979.

MOS...MOS...

Mos e pyet askënd për dhëmbë
në mos e diç çfarë shije ka.
Mos pyet askënd për mjerim
në mos të pastë ngrënë gjarpri.
Mos pyet askënd për kohë
në mos e njohsh orën e padukshme.
Mos e pyet askënd për fatin
po nuk ia ke hetua përkëdheljen.
Mos kërko rrëfimin nga fundi
në mos diç ta lexosh shikimin.
Mos i trazo ndjesitë me fjalë
në mos të përdheltë mendimi.
Kurrë mos kërko përgjigje
që njerëzit s' dinë t'i thonë.
Mos i detyro ta krijojnë borëbardhën
gjersa koten në andrallat gjelbëroshe.
Mos e gërmo tokën për thesarin e premtuar
se mund të mpihen gishtërinjtë.
Mos ia kërko lutjen e pathënë
lozonjarit ndër ethe qumështi.

Prishtinë, 25.09.1979.

MALL

Si prehem kur kthej ndër ju
në të rrallë
e u sodisë me mallin
dhe motive më kalë.

U lëpij me shikim fytyrat
e regjura ndër shkropa
rrah erërash e rrebeshesh.
Atëbotë merr krah mëtimi
më lëbyren sytë fëmijërisht
sa të mit më jeni
sa i juaji jam.
Po kur u merr tufani
e më veni arsyen mbi kësulë
(a shallbardhin)
dhe e djeg zjarr i lakmisë
ndër ethet e ndjellakeqja të pusisë
në hall halesh e fjalësh
- më bëheni aq të largët
e mbes vetëm pa vete pa ju
më tëhuajeni, qëndroj si hu
dhe marr malin:
atëbotë s'ë njoh profetin as diellin.
Nëse tek kordhni heshtas helmi
e të harbuar merrni sy
në dyluftime pas shpine a ballëpërballë
(të bindur se pas jush fati u pallë)

e bëni stërvaj lulet erëmira
natën e tufanit dehur nga errësira
- heu, sa bonjak më leni.
S'më keni dot, e nuk ju kam...
Pastaj i juaji, as imi më nuk jam

Rugovë, Shkurt 1981.

KOMETA IME..

Tryeza ime e shëmtuar/
sonte kupa ime e zbrazët
buzë e rreshkur;
sonte mëtoj pa zë
jam solidar
me ata që në tryezë
ndoshta nuk kanë bukë.
Nuk shkojnë tok
zemra e zbrastë
e gota e plotë
ose, anasjelltas.
Sonte nuk kam kremte
jam ulë këtu e zë vend
ndonjë gazmori a dasmori
dhe rri si cung i djegur.
E kam plot barkun sonde
po kjo nuk më mjafton.
Muzikën se dëgjoj dot
shoh si lëvizin solistët buzët
si memecët mundohen mbase
të më argëtojnë edhe mua
po, kot.
Kupën dua ta pjesëtoj sonde
me ata që zbrazët e kanë tryezën
e barkun.

Prishtinë, 31.12.1983.

TRASHËGIMIA

Në daç shpirtin - e ke shqim
kusurin nuk ta dua dot
trupit e mishit nuk qiten në treg, kot
sodrën, të lutem, vetëm sodrën
soll atë mos ma prek,
nuk kam ku ta blej tjetrën
nuk ta fal kush.
Nuk thuret më në vek
ajo është e tërë pasuria
nderi është, buka e njerëzia
ajo është këmisha ime,
le të jetë voglluce
dua të mashtrohem me thërrime
më merr çka të duash tjetër
por ma le atë rrobe timen
trashëgiminë time të vjetër.
Atë as s'e jap, s'e shes as s'e fali
kujtim brezash e kam
nga të parët varfanjakë
djale pas djali.

Prishtinë, 29.01.1984.

ÇAST (REÇETË)

Këtë lumë
e adhurova shumë
edhe kur qe më i kthjellët
edhe valët kur më morën pështjellë
ia dija dufin:
Çka nuk gjerbet e mori
e, unë shpesh qesha edhe nga zori.

O, si ta përpijë
atë hurrkamë
me tri ngërrkamë?
sikur të merrja shujtë
secilin minutë e dita gjithmonë
leje pikëllimin për nesër
për lot kurrë nuk bëhet vonë.
Si ta hukas disi mashtrimin
me cukla të mëshirës ta vesh.

29.04.1984.

DHJETË ME NJË

Nisem me lak në dorë
kërkoj drurin tim
degëfortë,
gjersa pyllishtës terrace
bëj nenin për fyt.

Kur befaz një lule
lëshoi vegzën
dredhë rrugën
helmishtës me gëzim
tek më grish
këngëtimi rishtas.

Harroj dhjetë murriza
me një lule mashtrohem shqim
si fëmijë me të bukurat përralla
thek hapin...
marr tjetër drejtim.

NDËRSIM

Lehu pas
sa herë të duash...
lehu rrudhave të shtuara
lehu dhëmbëve të rralluar
lehi mendjes së hirruar
lehi shikimit të mjegullisur
lehi kokës nga pakë të krisur
lehi hapit të ngatërruar
lehu jargëve lëvarur mjekrës
lehu sa të duash
këlyshi im i ri
ushtrohu, me kohë ushtrohu
dhe gatitu për durim, mësohu
do të lehu dikur edhe ty
lehi pleqërisë pa fije turpi
mos të vrasë ndërgjegje aspak
një ditë në atë shtegtim
(ne paq të gjatë...)
do t'arrish po n'atë cak
leh pra, leh pa dërdy
se nesër a pasnesër
do të lehin edhe në ty.
Ta them ndër sy
lehi pra lirisht pleqërisë
se do të lehin pas teje
diku më vonë.
Kështu e ka kjo rrotullake

që sillet gjithmonë:
Kurdo dënimi, një ditë
do të arrij të zanë...

Prishtinë, 1986.

NJOFTIM

Nuk jam pale e cofhtë (ngordhur)
në ferishte (fierajë) pa Zot
tek kthejnë stream rrugësh
uritur, pas nuhamës
e ushqehen në prapanicën e sajë
dhe ushtrojnë dhëmbët
për shujta tjera...

Prishtinë, 16.08.1986.

DALLIM

Ia hodha do rriska buke
dhe kocka përpara
ai hëngri, e lëpiu
pastaj më shikoi butë
lëvizi bishtin dhe kurrë
në mua nuk lehi...

Njeriut ia shtrova sofrën
me dorë në zemër,
ai ma përmbysi
e pastaj, i tregoi dhëmbët.

Gjykimi arriti vonë
tok me kuptimin
hasa soj mace.

Brezovicë, 14.08.1987.

BAJRYMERAJT

Kjo kodër dikur aq shungulluese e madhore
ndryshe merrte frymë, o shkretëtirë e trua.
Maja e Husës e Hajla, shpat më shpat
sikur thirreshin dhe s'afroreshin
as nuk largoheshin dot nëpër stinë.
Po në atë marrëveshje të heshtur
sikur kuptoheshin si fqinjët e mirë.
Me bulera gra e vasha truponin ograjave
e zbrisnin te krua i malit ndër çetina.
Na fëmijët zgërdhimeshim nëpër bllushtra
kura ato anash hidhnin pështjellakët
dhe zbrisnin në fierajë për t'u ikur shikimeve.
Me majsa rrihnin në krye të lugut të drunjtë
ndërresat që pastaj vetonin si smet boret
vetëm të ziera në finin e traditës.
Lisat na mbaronin Mrizin, kur bënte vapë
apo kur lëshohej shiu si me shekë
ndonëse aty shpesh prekte rrëfeja.
Po ne na kishin mësua prindërit që moti
ta rrudhim krahun e majtë që nën sqetull
të mos mund fshihej dreqi para gurërrëfejës
që del për gjah dhe djeg e gjumhisë shqim.
Aty bënte të qethurat Avdiu çdo verë
Shaban Sylja kërrmzavej dhe ziente krye sofre
e maza e ziemë apo koka e qengjit përpara
merrte kuptim vetëm kur shtrihej dorë e tij.
Nëse Musa shkoklonte hokat me te në dyluftim
tëbanët ngjit për njeri tjetrin qetonin o zjenin.
E sikur e shikonin Dudën te shtegu i Kullosës
tek kthente me një barrë dru në shpinë

me furkë në brez dhe shtizë e bosht lëvjerr
me grigjë përpara malësorja e moçnuar.

Zyka me të nipin në lëpjungë mbi shpinë
merrte mjaltë që t'ia ngjall dashurinë blegtorit
se “pipi me kohë do kthyer në kërrutë”
pa ditur se huq do t'i shkojë puna
se zanaku i saj nesër a pasnesër
do të shkarravis në do letra me larkë
e sytë do t'i le ndër shkrola
që bukë nuk apin as ujë, po marrin kohë
e tredhin mendjen kot së koti. . .
Si dreqin tani qenka bërë tufan Kodra
pa byrrlykamë tereqësh as jehonë zileshe e këmbanash
një nuhamë rrëqethëse e pret e s'ka as nena
Gjollat tani gadi i zë çufraja që përviulet malit
atje në shpat Nimanajt nuk lëvizin thnegla si dikur
që i kishim pasqyrë e ata matnin hapat mbi ne.
Çfarë tek ka ndodhur me Bajrymerajt e bërë pikë e pesë?
Do toka i mori e të tjerët jeta i sukullon nëpër vale
e u bënë shumë tyme dhe ngritën shtëpi e plangje
si mallohen kopetë rovishtave të vona Bregut të Mujit.
Në atë gjerdanin larosh tani i pështjellin ditët
po kurrgjë, kurrgjë më solemne dhe dallëdisëse
nuk ngjanë në Kodrën e tyre që i trembë edhe shpendët
dhe nuk kthejnë më pasi as troha buke nuk hasin.
Ajo mund të mbesi edhe ndonjë ditë vetëm ndër këto
vargje
ndonëse e meritonte një in memoriam më të denjë
po borxhin sikur nuk do të mund të lajë kurrë
pse më mallëngjen e vyshkur një ndenjë fëmijërie
dhe fjala më shtanget e mendje sikur më turbullon

ndonëse na ndajnë bukur do vite e vetit i them burrë
kur i kam Bajrymerajt, e spërkatur botës
pse n'tbanishtën e shkretume ma s'kthejnë as bishat.

Prishtinë, 1980.

UNË ECI VERTIKALISHT

Edhe kur më thonë poet a profet
edhe kur më thonë dreq me bisht
unë eci vertikalisht.

Edhe kur Bjeshkët e Nemuna më ngarkojnë
edhe kur më mbajnë para duarsh
unë eci vertikalisht.

Edhe kur më brohorasin
edhe me gur kur më godasin
unë eci vertikalisht.

Edhe me lule kur më presin
edhe qejt e tërbuar kur ma ngjisin
unë eci vertikalisht.

Prishtinë, 1982.

PLAGA IME - KOSOVË

T' gjykoi dreqi, a t'bekoi Zoti
gjithmonë t'jeshë fuqi baroti
prejse ra Kastrioti
t'nisi e zeza ndryshoi moti.

MANIFESTI IM

Nuk do të hidhërohem shqetësimi im
puhia ime përftuese, xixëlloja mashtruese
në ty, në askënd, në askënd, asnjë trok
pos në veti kuptova që me kohë
kjo botë kungulloqe është me të vërtetë
shtëpi e madhe publike - zjarrmi ose e qetë
ndonëse në derë s'ka fanar të kuq as emër
dhe të cilët zbrazët e rrejshëm shet_ç'mundet
në çdo hap e demantojnë veten:
pa cili ta shtrin gishtin, në jetë
si kashtroja shpëtimtare, kur t'kanoset përmytja
pa ta kërkuar pastaj kundërshtëpërlim
Njëmijë religjione e njëmijë parti
po aq urti, mësim e filozofi
të cilat mund të dehin gjersa je shtalb i ri
gjersa nuk të rrokate e zhveshur ajo kusi.

Jo, jo njëmend nuk do të hidhërohem nesër
në ty, në tjetrin, në askënd, betohem pa kusht
sepse në këtë tregtare groshët e kanë në grusht
sa më shumë mashtrohem, pastaj ma vështirë pajtohem
kur digjen ato kulla me kashtë
e ngecim si kërmij krejt, vetëm e jashtë
grahja me tënden, ec e sillu me vale
nuk mund të ndryjë jeta, të cilën ta kanë falë
kokën lartë, e ndër Amsterdam beteja zgjati
se nesër në të vjetër nuk të dolën këmbët e reja.

Unë, po ashtu i takoj kësaj tufe të bekuar
ndoshta skëterrë e herë pa mëshirë me kanë zguruar
apo frenin ma mbajnë mbrapsht demonët e mi
e s'mund qëndroj në shale me qesëndi
po rrxuallin s'doli kush ta mjekoj dot
po sillem gjersa të ma zë qafen keq kjo rrotë
mbase do të vajtoj nesër, andaj dua të këndoj sot.

Prishtinë, 13.07.1982.

PIKNIK GURI

Dera të pret – hape krah
s'besoj kurrsesi...
se ke mundur të ikësh dika:
je në ajër e hetoj praninë tënde
më je në vijëzim si krekë i lehtë
si siluetë e hije trupi,
më endesh damarëve
më qasësh në mëtime
në gjumë në rrugëtime,
je në çelës, dere, diku -
hap trokllues në shkallë
frymëmarrje me ngulshim,
më je gogësim e shikim
squfër e gaz i çiltër fëmijëror
më je diku, mbështetur
më pushon në kraharor,
më je përfitim drithërime dhemave
aromë rrobash;
më je nisma ose mbarimi
i fjalisë ose mendimit.
O, kot bën t'ikësh me trup
e të dënosh mua e veten
në gërhanë harrimi:
Ose qesh ndër lule gjithmonë
e hirrë e pata mendjen e fatin
apo qe kjo lojë djallëzore
e në ëndrra u përkunda -

shkunda krajatat prore,
ose, kushedi çka ngjau e ku vrau
por nuk më kap koka:
ashtu aq lehtë të ikësh
nuk të merr as toka,
por leri gjepurat
ta mbarsim zymtinë e jetës
me të tjera hoka...
Dera të pret hape krah
s'e besoj kurrsesi -
se ke mundur të ikësh dika.

PRE E PREMTUAR...

Një korb i uritur
Me fluturim rrethor
më pështillet rreth koke
e krrakat trishtueshëm
- pret prenë e vet
si premtim muzgu.

Ik, tretu këtej, shpend i trua;
më dhimbsesh, i gjorë
sikur humbas kohën kot
merr rrugë tjetër
piko një shenj tjetër
mashtrimi të tradhton
apo sot
je dehur kllapie e urie.

Unë s'jam shujta jote
jam gjallë, gjallë:
ngaherë, ashtu, mashtrohesh
si me gacat e shuara në dukje
me hirin përmbi.

Shporrmu, shpend futan,
e ke humbur adresën diku
ngjeti, e s'dije çfarë të gjeti
por unë s'jam preja jote;
mos i ëndërro ndonjë tufani

e sqotë...

Hiqmu, se flatrat ia le peng
kësaj bote, ish, ish, shpezëkumti shpresëkote.

Prishtinë, 16.01.1982.

THONI I NXIRË - ILAÇ

Si të shtrëngoј dhëmbët
e ti pije kokrrimit, pulbzat e
si të notoja njelmët e dridhem
e ta pres
dhëmbin e kalbur?

ta ruaj gishtin
dorën
trupin
si ti shpëtoj gangrenës
më dhemb, e më dhemb
rroçkon thoni
thoni im i nxirë
i qelbur
po dua nuk kam tjetër rrugë.

Zagreb, 12.09.1983.

GJELAS

Nuk më hetoi dot
syri s'e din as sot
se si e shkela...
Amerika, Rika, Ika
Amerika e madhe
Amerika e vocërr
ajo e ftoftë
unë i ngrohtë
test veshi
si bëri për mua
dhe njësoj edhe për ne
Amerika fenomenale
Amerika fatale
s'u morëm vesh
jemi një me një
ajo s'më bekoi
unë e injoruj.

Nju Jork, Zagreb 21,22.03.1983.

GJOLI

Loti im
bie në lumin e madh
e ai derdhet në detin e gjerë.

Po deti
avullohet ngadalë
e tevona bie shi, breshër ose borë.

E njerëzit
komentojnë në biseda
vetëm të reshurat atmosferike...

LUTEKOTE

Sa herë i ngrita duart nga qielli
m'u shemb hëna dhe m'u ftoh dielli
sa herë bëra të gatuaj bukën tonë
m'u shtjerr uji apo u krimb kokrra-zonë
sa herë ngrita dollinë për kurorë
më zunë ethet e m'u thye gota në dorë.

TRESHI ...

Paç tri shtama
një e theva,
dy më thyen
një e gërreva
dy më gërryen.

Paç tri lule
a tri crrule

S'di as vet
s'them se e treta
del e vërteta
pak si ndryshe
më mësoi jeta.

Tri e tresh
nuk merr vesh.

DALLGA

Në mua gufojnë kangët nganjëherë
e derë kur s'gjejnë me dale -
furishëm sulmojnë zemrën e mjerë
tu e shty kraharorin si lavë' e gjallë...

BETIMI

Qafimit tand s'i largohem, jam përbe:

- mortja pa m'herë

o, truall i dashtun, kështu si je

të dua, të dua përherë...

SOLO

Soll një dru
krejt kërcu
në pyllishtë
por shpeshtinë
vjellë e vjellë
vetëm rrëshinë.

Këndon kori
(vallë, nga zori)
fjalë e mjaltë
e gjurmët -baltë.

Ai zverdhon
e rekton
(kush s' dëgjon)
as shikon
kah tymon...

Nesër hirin
- si paspajin
ia merr era,
samar - fajin.

Shtog ndër fiq
e - deshi shokë,
kërkoi miq;
erdh me besë;
jetoj n'shpresë
ëndërr vdiq...

Prishtinë, 1984.

ERË DHEU

(C'est la vie...)*

Të lumshin këmbët
Markush Malcija
prej dherash të largëta.
Ç'e mira të solli këtu
ndër troje guri,
mos thneglat malli
marrë i ka për ty'...
sa here e shkele Monmartin
e përpive rrugë e rrugica
përgjatë Senës indiferente
me urat mbi shpinë;
a iu ngjite shpesh
Kullës së Ajfelit në thep
për ta rritur horizontin,
a të shkrumboi malli
për Malcinë tënde të thatë.
Mirë se të solli era, Mark
këmbët të lumshin
me ato miza të moçme...
shtigjeve tek këmbëzbathur
ia mate reliefin fëmijërisë
pas një bisht dhie.
Mirë jetojmë, si jo...
Ne u jemi mësuar të mirave e të tjerave
(C'est la vie", miku im i panjohur
mysafiri im i përçudshëm.

Po lere atë temë tani
mos më nga të të pikëlloj
- flasim për të tjera, solemne.
Nuk dua ta shuaj ngazëllimin
se më duhet pastaj, kam drojë
ta shpërlajë mallkimin e dyshimin
gjersa të lëbyren sytë me panorama,
udhëtar i karvanit të Evropës...
si më je, malësori i brishtë.
A u mësove me botën hujnike
dhe a ta shprishin gjumin shpesh
ëndrrallat, gjersa ditët e netët
i vargon si rruazat;
kur e shtyp gufin e çasteve
me kofshët, buzët e dhuntitë tjera
të ndonjë mike ditë a nate - minutare -
a të sillet ndërmend
ndonjë baresgë moshet
andej, tej djalërisë
së cilës i dridhej buza
e dora kur ta shtrinte
dhe u dronte syve e veshëve të natës
e të malit e të gurit
dhe shtojzovalleve, nga përrallat e pleqve
që rrëfejnë se ato ladrime e gërshetime
shuan vatra e harqe
nga trania e herëpashershme.
Vakt do ta kesh këtu ndër ne, mysafir i mirë
në trollin e gjyshit e babës, tek djepi
të vuri në gjumëmirin, shtruar me fier...

Mirë që na u qase, ore burrë
mirë de, kapim tjetër anë: të hesht, o
të prish gazmendin apo të rrej,
çka nuk bëra kurrë...
... Nga fjala Kosovë përpillesh shqim
se letra fotografi e fjalë
kanë ngjyrë tjetër...
Po, ja të them: na gjete udhëtarë
(ia do vrapin atit edhe ai që s'e ka)
jemi edhe ne shtegtarë
do caqesh që s'dimë si duken:
na janë përzier mistika, dëshira e fuqia
na errëson syri e vringëllon mendja
ndër vrapime - me mësimë e pësime.

Ndritojmë mbushur frymë
do agsholeve premtimtare e mashtrimtare
si heshta, si xhita, si era, si rrezja
Nuk jemi krejt ashtu...
si na merr e si dëshiron të ishim.

Dalin si shigjeta nga kjo arenë
apo plumbi nga grykë e hutës,
drua busollat na sillen keq:
nuk arrijmë tek përpjeta
as s'jemi ka na pate lënë:
muranë atraktive e befasive e fshehtësive
portable e gjithfarë kuçedrash
profetësh e perendish,
ndesh rrëfeve, kanuneve e lutjeve:

bijë mëkatesh të pabëra e të bëra
regjur e dergjur ndër sqota.
(Herë veti ia bëmë e here na e bëri bota)
ngutemi, mos na e shih për të keq
mund mashtrohemi edhe na
andej kah shgjetojmë, thonë, ka
edhe shtigje të kota:
të rënë në trans nga grykësia e ngutia.
Mund të mashtrohemi mbase, si me sheqerka fëmija
po tjetër va nuk ka, miku im i ri
C'est la vie, Markush, apo jo -
C'est la vie...
Mos u step që s'na gjete si të thanë
Ja - udhëtarë frumënëfyta - këtu as atje
ti rri e çmallu, në daç gëzohu
apo - tallu
por mos u hidhëro -
nëse nuk gjen çka kërkon, çka do, çka s'ke.
Jeta na fali do rroba të reja,
i kemi hipur asaj dhie të larme
o i ngjitemi përbishti
si fëmija karrocave të cirkut
jemi koptisur, ngapak të ngrysur
të mëkëmbur o në cacatje vargevi
nuk dimë në cak çka na pret
por nuk mund të presim, apo jo
do të thoshim - C'est la vie...
Mund të na këputet ndonjë fije
e të na tradhtojë hap a frymë
do të na vrasë, ndoshta,
ndonjë brymë. . .

Po rrenë e ëmbël na ngreh
për kërpeshi për veshi,
edhe kur na mpihen këmbët
kur na kërcasin dhëmbët, kur
vapa na mundon e acari na siton
po - ecim, ecim e ecim...
S'e di kur do ta prekim ylberin
apo do të prehemi në fund
dhe do t'u kthehemi rregzinave
(N'i gjeçin pas hirit e mushkut e ritimit)
e zhgunit e drurit e malit e zallit;
pasi t'ia mësojmë fatin e fytyrën botës
e dredhitë e pejgamberit e djallit...
Do të kthehemi si luftëtarë të zhgënjyer
të cilët i ka mashtruar kryekomandanti
në fillim të sulmit për t'i future në lojë:
pallate, arë e virgjëresha -
por kusht është - fitili i qytetit
dhe pastaj - i kanë lënë gjurmët nëpër hi
e nga ndërgjegje e vrarë u ka hyrë ftiga e ligë
dhe kanë bërë vetëvrasje - me vonesë
(zyrtarisht, mund të jetë lëshuar tjetër kumtesë).
Na ke gjetur në zjarrmi marramendëse,
nxitojmë trok o me të katra
po mos të mbetet hatri në ne:
erë benzine ndër hundë kemi, ka nisur
nafta të na nxehtë mbi troje kasollesh
ngrisim pallate - nuk duam këmbë të lodhemi
nëpër kate... fryjnë fjollë e të tjera re.
Përpiqemi t'i ulim në një sofër bashkë
Marks e Homer, Judë e Krisht e Muhamed.

Kryqëzohen tallagane e kravata, karroca e vetura
diku bëjmë o rrënojmë mure a ngrehim ura
gjithnjë më afër janë, me veshë, gra e burra
na tingëllojnë ndër veshë jehonë kut e okë
e masim me kilogram e metër
na bluajnë gurë të panjohur, do tjera gërshërë na
lakskërojnë;
uri epshesh, mode e piedestali kalimtar...
Mund të hasësh në çka s'ke dëgjuar në çka s'ke parë
por mos na gjyko:
nuk jemi na të vetmit mëkatarë.
... Ka, si nuk ka: burrëri, miqësi, mëshirë e dashuri
fjalë pa hale, ka trima dhe burraleca
- sa grima, o si vetëtima,
vetëm ti mos lyp shumë tivist i humbur në vatrën tënde
miku im i ri.
Kuptona - pak më butë e më gjerë
C'est la vie. . . Markush, C'est la vie...

* *Kjo është jeta (kështu e ka jeta) urti frënge.*

Prishtinë, 1985.

GADISHULL

Sa herë jam ishull
mykem shqim
e bluaj kotësinë
e përpij pelimin
e me vetëdije
lëshoj bisht
edhe andej
kah mund djeg zjarri
apo shembë guri
ose e tretë era
esëll nisem
të prekë në dikë
të më prekë dikush
para shiut nga fryti.

Prishtinë, 4.09.1985.

UJËVARJA E UJKANIT

Ku kishin çerdhet skifterët
e dhiegrat nuk përspjesnin kurrë
katrisej Kani, në djelmëri
atë moshë mazi, me gara
para se të bëhesh burrë,
e pinte ujë akulli
pa dashtë se poshtë kishte humnerë
ku mund të pushonte shakull
katrisej te uji i shkumëzuar,
mblidhte lertha me trastë krahaqafë
(e dredhtë) ndër mocanikë...
Tani kalores mes (serpetinave) leqeve
ndërmjet tuneleve kthen kokën lart
e lëpin shkëmbin me shikim
gjersa i rrëfen të nipit
do përralla të shkuara e të harruara
Bistrica letore ua përcejell bisedën
me muzikën e vet buçitëse e monotone,
plaku përçin ofshamën e thellë
e fërkon sytë që i rrjedhojnë
teposhtëzes vijnë gurë e lëng bore
të zhdergat ëndërron plaku tani
gjersa thikë nga Ashti e Hajla
(e flet historinë e vet të shterur)
tok me karvanin pranveror.

Pejë, Rugovë, Prishtinë. 11.07.1987.

DUET(I)

Herë më qasej rrëshqanë
herë përpara
e herë - herë pas;
më e vogël
a më e gjatë.

I ramë rrugës lik përgjysmë
ecëm trotuareve
buzë vitrinash.

S'e trazuam dot shoqi-shojnë
secili me të vetën
u ngjitem shkallëve tok
kat më kat
hymë në dhomë
- ajo erdhi e u rras në shtrat
e më shoqëroi deri në fund:
derisa mbi kokë
zgjata dorën e shujta llambën
(hija ime treti).

E nuk di kur do ta kem
rishte randevunë tonë
të zakonshme...

Prishtinë, 5.04.1987.

KROMA

Im babagyshi e katragjyshi
nuk e di në cilin brez
pat prekur kroma
e i përralloi
pastaj fjala u bart
ndonëse humben puçrrat.
Nuk e harroi toka
aromën...
po shoh prapë
m'ofrojnë gurkali
paç kujtua se ra në harresë
kromë e moçme...
Unë mendje shkurti
unë gjuhëgjati...
jetoj me barrën e mallkuar.

Prishtinë, 3.06.1987.

SPASTRIM

Lahem e shpërlahem vazhdarë
në lotët e mi të tharë...
unë piqem e digjem
e rishte zgjohem.
Dhe në vorbullën time
prapë kremohem
në kazanin tim
lyp shpëtim.
Më vjedhin gjumin e vonë
kujtimet e trazimet
rras kokën nën saçin e skuqur
mas rrugët e gjera të ngushta
përpiqem ta bluaj ajrin
ndër grushte...
Në mullirin e dreqit
ujem e qita trurin
tash kam vëlla, ndjesie
gurin e drurin.
Ndër dhëmbë bluaj eshtra
martirë, premtime e gënjeshtër.
Unë biri i vullnetit
që shalova Dhamsunën
të më bartë larg e larg
përtej shtatë detesh
përtej nëntë bjeshkësh.
U nisa pa shkop magjistari
vullnetarisht i mbylla sytë
dhe ndryshk bleva për ari

si ta kthej kohëzezën pas
e me cilën armë veten ta vras?
Eu, po pse s'më la fryma
para se ta kuptoj të vërtetën
Ç'të bëj tani me lëkurën
me kokën që s'e do kush
si shtamë, të shkretën
o, ku ta gjejë, i humburi qetësinë
me çka ta lajë gënjeshtren, mashtrime.

RRËFIMI IM

Unë s'i curroj veshët si lepur
kur rri e llafos me shok e mik
ndër dasma e të pame, në rrugë e kafe
unë nuk t'i numëroj frymë e ofshamë
as nam, as të shara as gjam...
Nuk të shënoj fendë e pordhë
as nuk bëj me gisht në ty
sa herë te jesh kordhë.
Unë s'e kam as ves të lig:
të rri me laps e letër në dorë
apo të përgjoj me magnetofon
të ta shënoj secilën fjali
secilën marri e secilën urti
që t'i ndajë pastaj në rrokje
sipas nevojës e rastit politik
(për përdorim praktik. . .)
Jo, pasha ty, të vi si gjeli në cung
ta lëshoj shpirtin në dorë...
e ti mund të më tallësh pastaj
mund të më bësh jorë!
Mua s'ma mban besa e krenaria
që janë motra të marres
unë trashamani pa program
i ngjaj qengjit nga pakë
edhe kur e kam ujkun afër
mund të ma hash kokën
por lëkurën e vesin
s'i ndërroj dot, lum miku

me a përpara apo pa të
merre si të duash sot
rrëfimin tim të butë
të cilit si vjen era barut.

GANGRENË

Primariusi më tha: ke sëmundje të keqe
i vështirë është shërimi
të duhet vullneti, durimi...
Unë heq thoin me të sjellmen e pare
pikon gjak e dhëmb nga pakë.
Mjeku shpjegon më tej:
- Është në dobi tënde
(r do jetën apo - atë tjetrën?)
Unë fjoj - këpus gishtin!
Specialisti ka vërejtje
e unë shtrëngoj dhëmbët
dhe këpus dorën pas llëre
po këshilla nuk këputet:
deri në bërryl, deri pas bërryli
unë, ekzekutuesi i urtë
vazhdoj latimin
me skalpet në dorë
me anestezion e pa të
lëpij plagët me gjuhë
këpus gjuhën me dhëmbë
dridhem ndër ethe
vallë, e hoqa mishin e egër
që më kanosej pakëputur ...?

VIGJILENT

Sa herë bie zgjebja në fshat
unë lyhem me gurrkali
e peshkve
në emër të preventives.
S'e di a mjafton
ky ilaç i mirë
që ta ruaj emrin
e dëlirë?

BIMË E TRUA

Stinë të trenta më tallën
i kam mbjellë dhëmbët
një nga një ose çift
nëpër argjilë e mumus
zallinave lëvruar me shputa
ndoshta zënë në shkëmb
të të marrin nofull.
S'di si u lidha kulpnajash
dehur krenarie
dhëmbë
bukurie
dashurie
e ligështie
lak e gjak
nuk dua hak.

Prishtinë, 1988.

KAPTIM

Dredhëzat tona
gati kurdoherë
na dolën idhnake.
S'pitem dot
lëvozhga e fara.

Ç'pemë kundërmuan vallë
ndër varfanjakët memecë,
katarakteve tona i molën
gjuhë më gjuhë
pajën, gjersa brimonin
dehur vesuar
xixëllimave të rralla
shkreptimave...

Prishtinë, 17.04.1988.

REPRIZË

Veshët e mi
u mësuam
me këto dautle.

Shpesh dëgjova
këso melodish.

Gozhda në kokë
heu se ç'mendje
mban kjo - tokë

Këto refrene
s'i kam të parat
po ku i lamë
të larat e të palarat.

Prishtinë, 13.06.1988.

EH

Kokëllartë Evropa përpara
e pispillosur e kredhur
(me madhëri burri)
tri hapa zvarget pas
Azia e përkulur
në mesjetë
ku ai thembrat
... kjo gishtërinjtë.

Prishtinë, 25.09.1987.

DIKTAT

Hesht, më lutën
ik nga këtej.
Ç'erë të solli
ç'nuhamë të polli.
Kot na rri brinjë
ik, për Orfej
nuk të ka hije.

Pejë, 25.10.1987.

DRY

Mos më shkundullo
ta di dhimbjen
ta kuptoj diagnozën
por s'e kam barin për ty.

Qetësohu, ta pimë bashkë
këtë gote ta zbrazim
mos na qoftë me gjëmë
po në dasma e përgëzime.

Zgjidhe atë lëmsh
që të gulçon
e mos ma sill gërrojsen
se kam mjaft zjarminë time.

Pa ngrite të gjorën,
mos të qoftë e fundmja
e mblidhi dhitë pak
në do të përsërisim edhe një herë
krropen e vjetër: bëhet mirë.

Pejë, 26.10.1987.

DISONANCË

Mora fyellin
t'ia luaj gishtat
për gazmend.

Po fishkëllimë
bubullimë e shungullimë
ma varrosën
ma plandosën
melodinë.

Ulërima e cingëllima
më humbi rima
e nis gishtat
mpihen, dridhen
rrudhen, mblidhen
grima -grima
m'u bë rima
ku qe vrima.

Gishtat thahen
ndoshta mbahen.

Mora fyellin
t'ia luaj gishtat
për gazmend
të ndjellë - shend.

Prishtinë, 23.10.1987.

MIRËNJOHJE

I ke pritur korbata
në shuplakë të dorës
e i ke ushqyer me thërrime.

Të kanë thënë
se je frikacak

e ata
ti kanë lënë
kurdo glacat në dorë
pa fije turpi.

Të kanë thënë
çka nuk thuhet dot.

E ti zemrën bujare
e ke si maza
dhe pa djallëzi
shuplakën kudo
ia shtron edhe sot.

FAKIR

Trashëgim i flakës
ushtrova me kohë
të mbaj gocat nën gjuhë
unë gogoli i (muzgut)
për mëngjes murriza
drekë me dije
darkë dajak.

Prishtinë, 1988.

UNË RRITEM NË GOTË

Përnjëmend rritem në gotë
apo lidhur si nyje pishet
por e di se një ditë
do të pëlças qelqi
dhe ena e stolisur spirrat
do t'i tresim anësh
e mjerë ai të cilin
do ta verbojnë
sepse një ditë, doemos
rrënjët ose koka
do të dalin prej gotës.

Prishtinë, maj 1988.

DITARI

Banorët e lagjes sime
i kam përtypur
prajshëm, prajshëm
e më janë mpirë dhëmbët
si fëmijëve nga kulumrija.

Ditët i kam njehsuar hidhtas
e i kam thyer në gishtërinj
si arrat vjeshtake pas vjelës
po krimbat shungullonin daullen
pikë
po nisë kapitullin tjetër
ju lutem - një titull të ri
për kryeradhën solemne.

Prishtinë, 1988.

XIXA

S'jam dehur unë
ncuk. Ncuk, ncuk
po gota ime e marrë
e pabesë...
sikur shtirret vet.

Fall

Ne patëm gjithmonë
ëndrën e pulës fat
mos na raft
ta përjetojmë
pësimin e saj.

KUMTI

Ishte rrenë
mua mund të më varrosni
mlagosni, plandosni...
po shpresën ushqimin e dehur
nuk mund të ma sosni.

ADRESË E GABUAR

Ikni ngjeti
mjekoni plagët
Klinika juaj
nuk ndodhet këtu.
Ua di diagnozën
po mos pritni mjekimin tim
barnat janë nën dry.
Zoti ju ndihmoftë
e fjalëbrishta ime krrope
kërkoni ngjeti mjekim e shërim.

Prishtinë, 1990.

TJETËR RRUGË

Unë s'mund të vi pas jush
ia kam dronë rrugës tuaj
nga përvoja e djeshme.
Unë nuk mund e ndërroj atë melodi
edhe n'ndërroftë dirigjenti...
Ju prapë të llastuar të mashtruar
mund radhiteni në korin e korbave.
Unë ia kam mësuar hymnin shpendkeqes
dhe e di tekstin e saj përmendësh
ajo nuk i prin dritës, jetës, dashurisë
fatit e ditës e rritës...
Mos ma merrni për mëkat
në mos ua paça besën
u njoh nga dje
burraleca.

Colegium cantorium, 1990.

PAJTIM

Mos i largoni, mos i dëboni
mos i shtrydhni, mos i gjykoni
fëmijët e mirë,
fëmijë të dëlirë
e etërve të këqij
bijë të fatit të zi...
Ata kanë mjaft barren e vet
ata kanë tepër, samarin e t'et.
Ata mjaft e kanë vuajtur dënimin
ata përditë e kanë përpi pelimin
ata nuk dinë për tjetër shtresë
ata i përcjellë hije e zezë...
Ua falim mëkatet
edhe bijve të këqij
të etërve të mirë.
Ata kanë lindur, rastësisht
si me pahir...
E kanë tepër lëkurën e vet
ndoshta një ditë busullën
e tretur kanë për ta gjet.

Prishtinë, 28.06.1990.

LUTJE SUPTILE

Mos m'bie vijë
fyturës sime, rrugës sime, hijes
murit të shtëpisë, dritareve
jetëshkrimit tim vogluç.
Mos m'i bie vi qëndrimit e qëllimit
plagëve të mia e vragëve
dasmave e përgimeve të mia
agsholeve as muzgjeve.
Merr gjithçka të gjesh,
lexues i pasionuar a i përgjumur
po mos bë redakturë në vizlën time
dorëmadhi ti shpirtvogli
ma përkujtoni ta them
gati si për mëshirë.

Prishtinë, 13.06.1990.

NGRITE KOKËN

(Poema e mezmit)

Në kohë t 'liga e mjegulli
Kuvend bashin do zotëri
vesh e mbathë për bukuri
titujlartë të gjithë pari
sofra plot e shumë gosti
se ç'po luajnë poker- parti
pse t'çajmë kokë na për Shqipëri
po na i prish do llogari
vërtet lyp hak e drejtësi
do frymëmarrje do liri
interesi por është përmbi
do të mbyllim vesh e sy
pak për mua e pak për ty
rrethua është me çapoj të zi
nga pakë gridh Mali i Zi
Mezë Kosovën kësaj Serbi
apetite ka në Greqi
jo sall Vlorë e Çamëri
thellë përtej e shumë përmbi
një kuçedër i thonë Rusi.

Urdhëron shkurt: Sill Turqi
një dhuratë Plavë e Guci
le të qetësohet Mali i Zi
bëjnë kongore kështu në Londër
punë e madhe Ohër, Shkodër

Shqipërinë do ta bëjmë lodër
nga Berlina vjen dënimi
me gjykim ekzekutimi
vazhdon loja me Versajë
plagë të reja dhunë e vajë
Shqipëri gjorën kush ta mbajë
luhet loja në tavolinë
ta bluajmë mirë ta laskarojmë Shqipërinë
vërtetë ka plane e mashtrime
fjalë të zgjedhura e premtime
porse duhen kalkulime
por mbi nderin drejtësinë
interesat lajnë përfshijnë
pak me doreza e hijeshi
politikë e kopili
i hapet varri nënës Shqipëri.

Ia fillon shekulli i zi
me shkretime e me uri
vuajtje, vrasje e mizori
nga fqikeqi zemër - zi
që s'kursen grua e flori
krejt Shqipërinë për ta përpi
gjak e plagë dhe shkrumb e hi
duan nga toka për ta zhbi
tym e flake shtëpi m'shtëpi
tokë e djerrë në bjeshkë e vërri
mal i pakt toke me bagëti
ndërron pronarin - pa tapi
hapën rrugët e mërgimit
skutë më skutë skena të trishtimit

zotërinj të rëndë po cakërojnë gota
eu po ç'fyturë më paska bota
bën të jetosh prej fjalëve të kota
se ashtu na u sjellka rrota -
njërit dielli e tjetrit sqota.

Një pas tjetrit ndërrohen motet
fat Shqipëria sikur kotet
prapë rrjedh gjaku pikojnë lotët
tash një frymë e re e kuqe
mollë e sherrit e fryt - huqe
Shqipëria ëndërron burbuqe
mall e ka bukën e kuqe...
Si të tërbua vëllai me vëlla
vazhdon shekulli plot hata
s'kursen pleq, fëmijë as gra
fryn dika tufan i ri
na i vjen erë demokraci
esëll shkundur varg e vi
i madh e i vogël bien për vi
të rilindi prapë Shqipëri.
Po merr muzg shekulli i zi
ndoshta kështu po ndërron miti
të lulëzojë pa erë baruti
u ngop dreqi e kuptoi Zoti
se s'bën me u shua fis Kastrioti
pa marr krahë ti moj Shqipëri
ngrihu në këmbë o përsëri
si në të ma të çmueshmen Iliri
sa murtaja ra mbi ty
s'pati bota vesh as sy

deshën t'gjallë për të përpi
por qëndrove pak pa u zhbi
n'troje tua strukë në pusi
tash të pret froni përsëri.

Të shijosh dhe lumturi
qenka shkrua të jetosh
t'vish në veti e të lulëzosh
brenç e halle t'i harrosh
një këngë tjetër që ta mësosh
rishtas jetës t'ia fillosh
zot i vetës për të dale
prapë me punë e jo sall fjalë
bëhu zonjë e pa halë...
Zëri i bardhë prapë të dalë
ngrohtë në shpirt e dritë në ballë
mjaftë me ty fatet janë tallë...

HYMNI DIELLOR (qiellor)

Gjeta margaritarë mahnitës bukurie
çfarë në fund detesh nuk ka
mbi faqen e dheut aso mrekullie
aso bukurie kurrë nuk kam pa. . .
As ndër yje, në qiell gjithësie
nuk ka dot as kurorë mbretërore
asnjë gjësend asnjë zbukurim
as unaza s'ka ashtu shkëlqim
në sytë e mi dashuri e pakrahasim
kam gjetur margaritarin tim
në meshën e shenjtë nga të pastrat duar
gjithçka në lutje e shenjtë e gazmuar
nga mijëra engjëj rrethuar.
Gjeta margaritarë, dorëshenjta zemrës dhuruar
fat i pamatur lartuar madhëruar
në shpirt më brohoriti himni gazmor
margaritar i vendosur mbi fronin e pruar
koret e serafinëve magjepsur si të hutuar
me xhelozsi sikur duke vrojtuar.
Gjeta margaritarin sa begati që kam
gjithnjë në te mendoj, kudo me vete e kam
ç'më duhen kurora dhe skopi - arë
Hostje e shenjtëruar është imi margaritar.

Ty Maria dua të ta kushtoj
këngët më të bukura që t'i dhuroj
ty dua të përkushtohem në tërësi

që nga ti të mos më ndaj asnjë fuqi
ti e tëra pa mëkate e plot bukuri
nga mëkatet kam shembje e zjarrmi
të lutem më shëro nga e shpirtit verbësi
më shpëto nga plagë - rreziku e ligësi
atëbotë këngën më të bukur do ta këndoj
këngëshenjtën e fëmijëve të dëlirë ta himnoj
tevona do të marr me të bukurën dhuratë
nga duart e nënës dhuruar pa asnjë mëkat
me engjëj këngën solemne do ta këndoj
atëbotë vetë me Zotin do të jetoj...

Pejë e Prishtinë, tetor 1991.

AMNESTIM

Do t'i falim
s'do t'i varim
s'do t'i tallim,
s'do t'i kallim...
për ligësitë, për çoroditë,
për prapësitë e për marrëzitë
për çmendurit, për poshtërsitë
do t'i durojmë, do t'i ledhatojmë
nuk do t'i gjykojmë...
do t'i ushqejmë, nuk do t'i urrejmë
nuk do t'i plagosim, nuk do t'i varrosim
të gjerët që ranë barkas a u gjunjëzuan
të mjerët që ulin qafën a prenë Rozafën
të gjithë ata që gropuan ose gërryen
të gjithë ata që lehen apo fyen
do t'i falim, ne shpirtgjerë jemi...
Tjera rrugë na presin, e tjera punë kemi.
O Zot,
sillna mendjen në vend, të paktën, sot
na ruaj nga të paprimet e tjetrit mot
se kam drojë, shumë frikohem nga stuhia
mos do të ngris prapë fundrinat, na merr furia,
na djeg lakmia, na përcëllon zjarrmia
na kot kllapia. . .
Më ranë shtatë lëkura me durim
më jep, fuqi, o Zot, për mirëkuptim
më ndihmo të shpresoj

një barkë fatlume për lundrim
po mbeta i betuar në bishtin tim cubel
vallë, ku m'shtie ky parim, ku m'del
a do të më pranoj, rishte, nesër ndonjë stil?

Pejë, 14.04.1995.

AGTERRI

Këtë mëngjes të kthjelltë tetori
gjersa bryma vesohet ngadalë
mbi maje harabadajsh kupë e kuqe
përsëndet ditën e re.

Më mjegullisë mendimet
pasi shikoj varur në mur
fotografinë e tim nipi
me kitarë në dorë, si poster
që mori rrugët e mërgimit në rini.

Vallë, bëzan tani kitarë e tij
dhe ç'tinguj rrjedhin hapësirës
mori adresash e numrash telefonik
më ngatërrohen nga Zvicra e deri n' Amerikë.

Tek i shkapërderdhi murtaja
pjesët e trupit e mendjes e zemrës sime
një zbrazëti ma zgropen zgurin pakëputur
fshihë ujësimin e syve si mëkatarë
që të mos jap shpjegim e arsyetim
përpiqem ta, ushqej shikimin
me koloritin e vjeshtës së bukur.

Dal e nuk numëroj delet galusha
gjersa zhuji kuis e nuk më njeh
kurrjë më këtu nuk është magjepse
një natyrë tjetër, e shëmtuat
mezi ma thith ditën e natën e gjatë
në kungullin e turbulluar mejtimet ndizen.

Kalamajtë e Lumes kanë programin e vet
bjeshkët më rrasen në fokus haptas
madhështore mikeshat e moçme të njohura
që sot më janë tjetërfare, ato prapë janë
pothuaj të pandryshuara, vetëm të plagosura
një gufë e ngushtë sot ma ndal frymën
kësi mëngjesi sikur m'i përzënë rrezet në dritare
mashtroj mendimet si fëmijët
me bonbone të larme, kur qajnë.

Nuk di, cila ditë kalendari është sot
m'i rikthen kujtimet, gëzimet e pësimet
jam këtu apo një anije diku ngjeti më shpie
sikur gjithçka është në të perënduar
ç'mu tek të vijë këtu, për çmallje e tani
bollat më sillen nëpër bark e kokë.

Hej, po ç'ndodhi me ato bukuri të shkuara
ku u varros fëmijëria ime e hollë...

Shkrel, 7.10.1995.

VDEKJA E POETIT

S'patën nevojë fare Din Mehmeti
ta harxhojnë plumbin për Ty
pasi t'i rrënuan krahët
atë grim rrezehanë
që ta zëvendësuan drekën
pasi ta këputën frymën
pasi ta dëgjoni atë kokë
të Rrafshit të Dukagjinit
s'patën nevojë fare bacalok
të ta zbrazin plumbin në Ty
sytë dritë të kanë mbetur hapur
sytë që shkrijnë dashni, njerëzi e mirësi
Din, miku im i urti, i durueshmi
ta këputën fjalën, frymën
më herët, më parë.

Rozhaj, Tiranë 4.04.1999.

URDHËRORE

Dilni prej emrit të huaj
që vjedhur e keni e përbaltur
prej fesë të cilin e thurni si merimangë
brimojen shpëtimtare.

Prej komit që e bëni
sa herë keni nevojë
prej fjalëve e titujve
që ndotën në gojën tuaj.

Dilni në skenë lakuriq
me gjithçka keni e nuk keni
ju të nëntëdhjetenëntë,
dilni lëkurës së huaj
lajkës, mendjes, rrebeve.

Ç'veshni martirësinë e rrejshme
si këmishën e palarë
mënyrën e pangopësisë,
mëshirën e trungut hidheni,
dilni e leni lëvozhgat
si gjarpri në pranverë lëkurën e vjetër,
lini tëra magjitë:
shtëpitë publike që përdorni
kishë e xhami si të ju duhen
herë vend e kuvend,
pusi e ka komb shpëtimtar.

Dilni prej emrit të huaj
e mbiemrit të vjedhur
lirojini lëvozhgat
pale mos gjendet
birë lokje i denjë për te.

Lirojeni më atë skemë
jeni aktorë të lënë
se pakcili ju duartroket më.
Ikni para se të bjerë perdja
(kashta më nuk shitet).

BESNIK BJESHKA

Ooo, shporruni që këtej, ardhacakë të mallkuar!
Ç'mëkat bëra që më kanoseni egërsuar?
Këtu, së pari, pashë agullimin, vezullimin
Zërin e pare lëshova hapësirës, shkëmbit e lugjeve bucak
këtu me njohin bimë e hormoça e shpezë
dhe bisha e cegma e shira, rrezet vjedharake.

Këtu ari nuk ka, as tokë pjellore, asgjë tjetër
që të grishë, por mua më lidhin kujtimet, gazmime,
hidhërime
grigja më njeh, shpate dhe kroje, rrugica
tek bredhja kopshtit të fëmijërisë... shtëpi druri e vjetër
Këndeypari defiluan hordhi e ndodhën mizori
kujt borxh nuk ia pata, as fjalën e rëndë.
Nuk ia preva mizës zukamën, zogut ligjërimin
bishën nuk e shqetësova, lepurit shtegtimin
nuk ia ndala, unë orëpreri-në vatrën time.

Nisa të hap libra e të koptisem andej tek mendja
të shpie, rrugëve të tjera, matanë së panjohurës
unë këtu në Hajlën e Keqe thitha gazmimet e rralla
grigjën e zvogëluar mallova pllajave e lugajave.
Kush u ndërseu këndeje, për të qindtën herë, me zjarr e
vrer.

Që të prishin plangun, të më dërdyni një ditë mendjen
e prapë - po më glasoni mbi ballë, po më shkëlmi në nder.
Unë, me të madhe e pata zemrën se armën, në pragun tim
desha të mbroj shall e tirq dhe plisa e lisa

rriskën e hollë e melodinë e krijova akull.

Kujt i pengoi plangu i Lakajve, o, të krisurit e rruzullit
që m'i trembët zogjtë e bletët dhe ndalët shqim
rritën e mjedrave, dredhëzave, lëpjetave, luleborës?
Ç'u solli këtejpari, hordhi të horrave, darkë e sorrave.

Pse u mbërthyet, si u ndrëkyet, fëmijët e shkinës?
Pse ma zutë pritën, e më vratë - pas shpinës. . .?

Në tokën time isha, pip varfanjak, nuk doja gjak. . .
nuk di kujt ia shkela këmben, nderin, kujt i kam hak?
Hija ime këtu pari, bri Shtedimit, Hajlave thepake
do t'u bëj roje, gjersa të jenë këto troje...

Prapë, do të dëfrehen qengjat këndeje, bletët me hoje
në mos i paça lerë Zotit - tepricë, qofsha peng i fundit
m'altarin e lirisë, le të mos jetë kjo ditë e zisë.
Unë u koptisa majave tjera drejtë lartësisë e lavdisë
busmin ta shpërblej, t'ia kthej borxhin burrërisë.
Pranvera ime e fundme, qoftë nisma e rrugëtimit të nuses
që pret soji im me shekuj, me dhimb e psherëtimë. . .

Bën pa mua Rugova, soll le të kthen mbarë Kosova
le t'agoj gazmimi, unë si rashë, formë vetëm ndërrova
tokë e stërkequr le të pastrohet kalbësirës, errësirës,
zullumit
le t'i vijë fundi, të mos harrohet dhembja, loti e mudi.

Tiranë, prill 1999.

LICITACION

E kam qitur shpirtin në treg
nuk di si do vetet çmimi
mos s' dua djaj ka blerës ngulm
dhe ku do të përfundojë...
Mund të mos gjenden blerës fare
e pastaj mund tubojnë mallin me kredi
apo më duhet dhuruar të çmuarin
dhe mbetsha i undit me te në tregun e larë
nuk i duhet ofertës e kërkesës
me pritmet duhet prirës, por jo burrë.

Prishtinë, 15.10.2000

LEHONË

Bëri shtratin me ulkonje
po krijesa e re më rrezikon.

Filloi lehjen, o Zot i madh
ku mbolla murrizin tim
dhe në cilin litar tani
ta vari lëkurën puçrrake.

Pejë, 15.02.2003

STAFETË

Flasin: zenë i kaploi jeta
tim gjysh, por unë s'e përpjeka.
Thonë: i urtë që për të drejtën
por edhe rreban, sikur i krisur nga pakë.
Malet pat plang e shtëpi
po keq që me djallin, mbretin e krajlinë.

Im at iu gjegj kushtrimit:
nxori nga hatullat martinën e ndryshkur
me tre fishek e gjysmë iu sul armikut.
Kur e tradhtoi huta -
rroku sëpatën shpëtimtare
e në fund fytafytas deshi
të mbrojë emër e vatër...

Unë, biri i tij, mbi gërmadha
gurëthemelet i vura pallateve
urëtova rrëke, shtrova rrugë
rrafshova kodra e lidha ura
anëmbanë vendit tim diellor
ushlat i rendita trofe betejash.

Im birë, sot shtegton
me një qerre librash nën sjetull
shikon me vetëbesim lartësitë
e mi sukullon para sysh
Homerin, Pitagorën, Anshtajnin...

Gjyshi im do të gjente një shkas tjetër
im atë, ndërkaq betohet në frymë e plagë
unë kredhem me ushla e kurset analfabetike
po im bir hidhërohet e nga pak më shkumë
sikur krekoset: që të tërë së bashku
nuk do të peshonit - sa... unë!

BOSHTI

O, në qofsha unë ai
që me shkop - vetëm
o, në qofsha ajo flatër
që tëra bjeshkët i përftoj.

o, në qofsha ai lum
që tanë anijet i bane

Në qofsha ai bosht i vetëm
rreth allit sillet bota

- mos qofsha as vet.

EPIGRAME

Pa më shpjego
zonjë fallxhore:
ç'bën në fund
pasi shtrydhë
ta kesh limonin
- me ato lëvore?

Kësaj pune
si m'i thua
unë me ty -
e ti... pa mua.

E ujkut kimën
kur ta qesin
veç me plumba
në vend dhurate
kudo të presin

Me cigaren
vihem në garë
pale kush -
digjet më parë.

Pak si të keqe
- atë lojë
pse nga brenda
një përmbajtje
e qet për gojë.

Është trimëri
por kam drojë
prej atij që
materialin e
'katit të poshtëm'
e zbrazë për gojë.

EKULIBER

Në mos e gjesh ngrohtësinë
në mos e gjesh dashurinë
në mos e gjesh lumturinë
ruaje t'paktën – qetësinë.

Po i përpive gëlltitë
mos e durofsh marrëzinë
po s'e bajte tradhtinë
po s'e durove mizorinë
ruaje t'paktën - qetësinë

Prishtinë, 6.05.1992.

TERRAQ

Me cilën thikë prejme orët
lik për gjysmë natë e ditë
gjersa na del muzikë e hollë
a tingujt e tranuar
ku e mbyllim thesin e shqyer
dhe fillin e nisim (risht)
me agsholin premtimtar
nga fluturaket e çmendura
aromë grash, djerse e parfumash
tym cigaresh dhe erë bari
vesuar me natën e butë
grishim kujtimet e shujta lakmitare
çfarë dite dot ë kemi nesër
çfarë do të shënojmë në ditar
të vemë e të bëmë përzier
gafat kush do të na i numëroj nesër
çfarë do kenë gazetat në ballina
terri a do t'i mbuloj mëkatet
varri i rrenave a do të mbushet
po fjalët e shkepura falas
kush do t'i fus pas në shishe
kujt do t'i këndoj kendezi
e cilit pulë do ia prishë gjumin
mbi çepallat e ngarkuara
vallë, sa do të shiten krropet
për shtretërit e zbrazur, lotët,
djersën, pedatjet, tranajat...

Do këputet litari
kënd do ta zgjoj kumti a dasmimi
cilin përgimi a pikëllimi...

Prishtinë, 28.05.2004.

POSTKRIPTUM

Mos ia shishmo qenit
gjakun e njeriut
se nuk di
çka do të ndodhë pastaj.
Ruaje shijen e gjuhës
dhe urtinë e dhëmbëve
mushkut të mirë katërkëmbësh
dhe bashkudhëtarit tënd
s'u dihet shtigjeve
gjuhës, dhëmbëve e barkut.

Prishtinë, 9.12.2004

MAGJIA E MASHTRIMIT

Cilës lule do t'ia merrja erën
cilin kalë do ta shaloja vet
në cilin burim do të shuaja etjen
cilin pyll do ta paketoja - sogjoj veten
heu, po cila flutur do ma vidhte shikimin
tani rruga m'është më e gjerë
cilën fjalë do ta zbuloja para teje
cilën ditë do të kremtoja si timen
cilën ëndërr do ta kisha virgjër
ore pa mu që vajtët, shumë mirë
por loja e pafund kështu e sjellë...
Kjo rrugë rrugaje kështu rrotullohet
rrotofojka e mjerë e rrënimeve
kjo mrekulli e jetës, kjo ekstazë
kjo magji e vdekje për jetë
është shkundullimë e amshueshme
kjo simfoni e fillim mbarimit
është shpikja ma e madhe.
Nëpër rrotullimet tona.

Prishtinë, 12.03.2004.

UDHËTARI

Jam koptisur shtegut të bardhë përpjetë
rruga ndoshta ndokund lakadredhë
e më përthekojnë muret e ngushta, shkalla e shtigje
o mendja e mazit ma jep pyllishtën
mund t' ma ndal pakëz hapin pela e zezë
apo të më kanoset me shkelma vringëllues
por unë nuk do ta thyej rrugën dot
ndoshta do të cacatem si foshnja mitare
por nuk do t' ia lë fajin mjegullës
nëse do të më përpijë guxim e drejtpeshim
në mos arritsha vet në stomin e premtimeve
më mirë si muranë e ndritur
ta shpie qëllimin porosi agsholëve.

Gjakovë, 21.03.1981.

HAPAT E M I

Nga ekrani, nga eteri
marr çdo mbrëmje
helmin tim.
Për çdo mëngjes
ma përkujtojnë shkrolat
terapinë time.

Me to, prapë, filloj ditën
marrë pasaportat e mija
për udhëzime dinjitoze
rrugës së trasuar
nga gjithfarë mjeshtërish.

Rroftë e qoftë
informimi
hapëroj e nxitoj
- nëpër kthesa, me ngatërresa
me duhi e me fuqi
(me ndërskamsa e me pusi)
herë pa kokë
herë pa sy...

Rroftë qëndrimi:
qoftë udhëzimi...
flenë guximi
m'mban durimi
secili udhëton
tok me të veten

ja dhe unë
me familjen
më duket se
e kam biletën
për atë cak
për atë tokë.

Prishtinë, 26.10.1987.

DREDHË

Në pemishten e rreme
askush ditën
s'e nduk një fije
një kokërr...
Askush nuk i blen
ato pemë,
që i ushqen fjala
aty vijnë natën
nëpër terr...

Prishtinë, 1987.

KËRCËNIM, MONOLOG, AUTOKËRCËNIM

Me ty punët s'më veten
andaj ki mendjen:
mos ma luaj shenjën
sa herë vranë e kthjell,
mos mi tjerr ditë e natë së mbrapshti
mos më hidhëro, mos pështjell
ag e muzg dhe gjymtyrë e kulpnaja
mos na ndërro gëzofin... që pastaj
të më bëhesh be e rrëfe
kush më je
të bien dhëmbët nga fjalët e mëdha.

Hiqmu ndërkomcave e thashethemeve,
shporre hirrën e trashëguar
në kullojsë kaltëroshe
mos më bind se bota është rrumbullake apo qoshe
shporru vesëmbëlsirës
e mundja me qëndresë
ëndjes, ligështisë, smirës,
ruaju lakadredhave
e në marrësh rrugën e edhave-
mos ia le pastaj fajin dreqit e të birit
varrit të katragjyshit
mos m'u lajë në shtog
mos m'u beto në Zot as në zog,
ruaju mos bën lehtë me gisht
e qëndro kur të merr furtuna
mos u ul në bisht!

Unë përnjëmend e kam me ty
flas seriozisht.
Nuk do ta fal në ta veshin
lëkurën e gomarit
do të ta mallkoj edhe varrin e të parit...

Në të zura në arën e pa gardh
mos m'u beto në dëlirësi e profet
sepse në kuvli, farkatar
nga pak pate kohë të latohesh vet
dregëzave të shekujve
bleroshi bonjak.
Matu, matu mirë
mos të zë në hak
se druaj pastaj, druaj
nuk do të del det as lum as krua
të të lajë
e din çka...
e zeza do të na shpërlajë.

Unë, unë do ta bëj timen
e me njëmijë e njëqind e një
bota me mua nuk sos as nuk zë
unë ta them burrërisht
prej teje do iki
larg, do të tretem diku.

Ashtu, do të ta lëshoj lëkurën
emrin, shënimet biografike
hartën gjeografike

shok e të tjerë
ndonjë mike
bjeri vijë, do të urdhërojë
bjeri kësaj pune vijë
nuk qe, nuk ishte, nuk ngeli
asgjë pas tij.

Pres ta them këtë këshillë, merre si kërcënim
po më more pyllishtën, ti Uni im..
do të ikë prej teje, do të ik prej meje
pa diskutim, pa këshillë, pa leje
do të shpërlajë më parë prej kreje
atë shtamë që u mundova ta zbukuroj me ngjyra
të ta them troç e pa të keqe
ta dish më mire, të mos zë
duke më bërë leqe.

Nuk mund të ta falë gjithmonë
atë moshë mazi
edhe ca është i vonë
kur të mpin loti a gazi..
nuk mund të ushqej gjithnjë
me arsytetime të liga
të ta them, më mirë
kima drone...

VESEË E DETË

Mes nesh janë muri kinez
Misisipi dhe Himalajet.
Mes nesh dritëvite
kujtesë e harresë.

Ta marr në parzëm dertin
të të ushqej mendjemiras...
me një mijë mundime...
Unë, vetëm vesën e kam
e cila më djersitë ditën
pastaj rriten retë e mbarsura
dhe më sjellin shibutin,
më rritën edhe pemë përrallash
mbi zallinë Saharë e pastaj
lumenjtë mi bajnë barkat
që kurdo kthejnë te unë
lundroj tej detërash
tej bjeshkësh, përtej
shekës së shiut dhe kështu
ushqej gazmimin e fëmijës...
Njëmijë mrekulli
m'i fal vesa ime,
dhe gjersa lundroj
amshimit, gjersa flatroj
mejtoj dhembshëm për ty:
Gjithçka ke: det e lumë
por kallinjte edhe hëna
t'i bën shkrumb.

Anija jote s't'i banë pendlat
ta shter detin droja
në mendjen tënde banon Troja.
Ta merr gjumin shtrigë e shlligë
ta brenë qetësinë me daltë
një mendje e sëmurë e ligë.
Të ngrin deti, oqeani e të thanë lumi
tradhton fare e bimë e pemë
e buzët plasa shkrimi...
Mjери ti e lumi unë i lumi
s'ta dua detin që ka drojën
lum miku këtu e harrojmë
rrjedhën e agsholit e lojën
s'ta jap vesën që ka shpresën
për çka ke, tërë pasurinë...
unë kam plot syrin e qetësinë
kështu udhëtojmë, udhëtojmë
ndonëse brijas, afër e afër
dhe aq larg tepër larg
si kojrrilat kur marrin varg:
ti me det e me drojë
unë me vesë e me shpresë.

STREMI

Soll gjezdisë, kahdo krejt i lirë
s'është i askujt
e është i të gjithëve
nuk ka emër, tel as zinxhirë
nuk i leh askujt ose kujdo
han ku e çka të mundët
pa faleminderit, mirënjohje
sot këtu, nesër atje
reagon vetëm me qyp e kut
bredhë, bredhë, bredhë
e kujtime mbledhë
Qeni proletar
pa emër
pa tel, pa zinxhirë e pronarë.

Prishtinë, 27.05. 1983.

REPRIZA

Goja iu thaftë goja
atij që më la trashëgim
urtinë mashtruese.

Kolli i keq
të prek
një here në jetë
vetëm njëherë.

Goja
iu thaftë goja
atij që trashëgim
na la urtinë mashtruese.

KOTËSI - VIZË

Vetëm kot e mashtroj veten në mejtime si erë
se po të nisesha rrugëtimeve rishtas edhe njëherë
do të koptisesha rrënjëve kah janë vetë lëndinat
dhe do të kërkoja hijet e të zhbiroja si urithi bucinat
nuk do të ndeshja më mureve gjithfarësh tek hasa
që desha ta latoj me kokën time si t'ishte nga rrasa
as në cifunat e ndotura që desha t'i kthej
në lumet ujëkulluar të shteren shqim, i urrej.
Kot e rrej veten se do të lypja lakadredhë
ose do t'ia shitja shpirtin edhe dreqit të verdhë
dhe nderin e fjalën, për cukla e Olimp mashtrimi
se nuk do të më shkrepse vetulla - turpi ose galdimi
fryma nuk do të më dridhej nga dhembja kurrë
njësoj në kandar peshoj - kurrkush ose burrë
kot mashtrohem si fëmijë në veti, për fillim loje.
Prapë këndeje do të vetësia: me krajata, plagë e droje
Epitafin veti ka herë ia kam shkruar në mendje
tani merimangë gjelbëroshe kot më mashtrohem me ëndje
lojën e nisur si premierë me kryeneçësi e vijoj
mund të më vijë gjykata, ndoshta, prapë, vet gaboj
qesh tregtar i keq apo kush dreqi ta dijë çka ngjau
ashtu le të jetë: kurrkush kënd sot si dorë e vet s'të vrau.

RECUIEM PËR NE

Ku banon gjithë ajo zemër,
n'atë grim trup...?

Nënmadhja jonë
Motërmira jonë.

Pusho e paqtë me Zotin
prehu e paqtë me njerëzit,

Nënmadhja jonë
Motërmira jonë.

Vetulla e ballit tim
pasqyra e shpirtit tim,

Nënmadhja jonë
Motërmira jonë.

Mos u pikëllo kandili im
falja mëkatit ligësisë,

Nënmadhja jonë
Motërmira jonë.

Në muajin e udhëtimit n'amshim
nuk pati vend për këto vargje,

Nënmadhja jonë
Motërmira jonë.

Ditorja shqiptare kishte mbushur
një faqe për Ledy Di-në plot,

Nënmadhja jonë
Motërmira jonë.

Këtij rruzulli do i veja tjetër emër
e një fanar të kuq në hyrje,
Nënmadhja jonë
Motërmira jonë.

Ti, vërtet nuk ishe princeshë
ty të kishim mbretëreshë,
Nënmadhja jonë
Motërmira jonë.

USHQIME

Më lëreni pa ajër
pa ujë, pa bukë,
leckaman;
në vapë, acarë.

Dua: vetëm
një gjerbë - liri,
para se të mbyll sytë
përfundimisht.

Rozhajë, 1.04.1999.

Ku

Ku më pret
shtëpia ime
e fundme?

Ta paloj
vetëm lëkurën
si thesin
e shqyer
e kocka?

Podgoricë (kalimthi), 3.04.1999.

SHQETËSIMI I SHQIPONJËS

Zot, po ç'brengë ka kjo çupëz
si u llahtaris kështu shqim?
Asaj i dëgjohej vetëm frymëmarrja
dhe gojën e kishte për ushqim
e sytë e gjumit, kokrrosh rrushi.
Butakja bukur si ndërroi befas
eu, po ç'dhimbje e dhembje e trazon
si klithë e vazhdarë lotësh bien
si ky shi rrebesh pranvere futake
përse na shikon me shqetësim
si s'ndihmon gji nëne, s'do miklim
si ka ndërruar, si ka ndryshuar?
Mos e ka fatin e emrit, e lumja
e rropatemi me te kot
drojë, mos ndonjë zë kobtar
nga dika sjell kumte,
e ajo shkrihet e derdhet
në vaj e në lot, o Zot!
Ç'e mundon Shqiponjën tonë
që u vënë kësulë e bëmave
në këtë jetë - zone
mbi kurrizin, mbi shpirtin
mbi barren tonë...
Nuk luan më me doshet
s'na do as shikon dot,
e na s'jemi mësuar ta shohim
as kur përloshet...
Shqiponjë, Shqiponjë, mos - plaç
t'u thaftë loti, me kaq!

Tiranë, 4.04.1999.

ADRESARI I VJETËR .

Më pështillen nëpër duar, xhepave
nëpër kokë, në lecka letrash
nëpër fletëza e blloqe...
Po askush tani nuk gjegjet
atje ndodhë ferri, lidhjet
e fijet janë këputur,
dhe frymët
e damarët
dhe kokat.

Vlen, vallë, gjysma e adresarit tim
ose vetëm çereku i tij...
Janë zhdukur telefonat ose
të zotët e tyre?
Nuk di pse s'marr guxim
t'i fshijë ata numra
dhe të formësoj
adresarin e ri
memeci unë
trung...

Tiranë (mbrëmje), 16.04.1999.

ÇELËSAT (AJRI)

Ç'më çaplojnë thatë
si këmbanë e tretur
që nuk e gjen tufën.
Nuk kam dorë t'i hedh
as nuk di pse i barti
tani ato porta
do të jenë hi,
as zgafellja pas tyre
nuk do të paraqitet kush
dyer e dritare janë shkrumb
muret e rrënuara,
pullazet e rrëzuara
gërmadha e gremina
Made in Serbia.
Pse më kërcasin
sikur flasin,
bërtasin -
çelësat e
....ajrit.

Tiranë, maj 1999.

FAT FUTURE

Të grish kandilin
me flakën shqim
të t'i nxehtë flatrat.

Si të mashtron kuqëlimi
të josh ngrohtësia
që shemb kufirin...

Ç'magji të tërmek
që të bie pre befas
vjetrusha ime rinore.

Shpesh ta shkruan përkujtimin
ta luajtën edhe muranën...

Ti zallishtes më lëvaresh
druaju diellit zanak
e lakmisë grykësisë.

Shqipëria ime n'ethe,
mblidh mend e muskujt
ruaj lejlekë e strofuj
në daç të më kesh.

Ta di dhimbjen e hallin
po ta veti moshën?
Atdhe, ngritë ballin.

Durrës, 29.05.1999.

MERSI, HYSEN

Njëherë të mësoi babai i urtë
të thuash burrërisht: t'u rritët ndera.
Tevona jeta të mësoi
edhe një përshëndetje tjetër.
Pastaj në Anadoll mësove vet
“te shykyr abej, te shykyr...”
Bota nën thumba nën sjetull
tani në truallin e tretë
mësove: “mersi, monsieur ...”
O, vallë edhe sa herë
do të kesh nevojë, lum vëllai
ta thënësh gjuhën në, - përshëndetje..
As ti s'e din, mësa unë
sepse kush e din nesër
si do të shartosh fatin.

Lausanne, 12.04.1971.

SHUJTË KRIMBASH

Tërë jetën time të vockël
ushqeva krimbat e ata pareshtur
ecën damarëve e trurit tim e plagëve
të mëdha e të vogla, çfarë dita më dhuroi
vrraguan në rrugëtimin e tyre të verbër
dhe ma zunë frymën e marrë, ma këputën shqim.
Hej, lumi unë i lumi, për sorrëpimet e mia
mi bluan ditë e natë në mjegulli
kursesi, të vi në veti e ta kapi fillin
të shikoj zgjuar, pa ëndrra fëmijësh e pa mashtrime.
Kurrë, pa gjerbë tri herë, s'e dita cili qe pelini
sikur s'e di ku më shpie ajo rrugë e gjorë.
Po të isha më i qetë, më shigjetë e më i imi
po dikur tredh mendjen me të pa të lana
ndonëse e di se krimbat s'e ndërrojnë vesin
(çfarë janë në fillim deri në fund mbesin).
Përse martir të bëhem për ta, ore
koka ime e vale, si zonë që më hijeshon e rëndon
me gjepura, me njëmijë peshë të papara...
dhe më me, të palara.

Prishtinë, 20.04.1979.

SHTEGTARË

Mora rrugë këmbëzbathur pas kalorësve të blertë
me shikimin që shigjeton caqet tej horizontit
llahtarin e urisë e paç shok udhëtimi.
Mbi shufra të skuqura u turra shqim agimeve
po a do të më mashtroj hapi e fryma ime
dhe do më lënë lakuriq në logun e larë huti
ku do ta var lëkurën time irnake
si tutaç vrrije që të trembin kalimtarët
mos më mbesin në fyt rozgat e motive
dhe përpij bulshat në turrin tim fëmijërorë
pup gardhiqet i kapërcej si ylberin përrallor
e thek hapin luledrizave para busullës ndryshkur
si nusnaku i mpirë habije e pritëgjatës së ëmbël
hej, mos e përpifsha gjuhën time o në trokun
mos ma preftë ndonjë trung i truar
mua maratonistit të vonuar
të dashuruar në vetveten.

KËRKIM

Përpëlitem e përpëlitem, kërkoj
ta gjejë njeriun që me tri fjali
merr vizën për trurin tim
e pastaj, dalëngadalë
do t'ia bëj pak strofull në zemër
- si qyqe jetën si ta jetojë?

DON KISHOTI

Do të ketë njerëz që fjalën e parë
nuk ta ngatërrojnë për tjegulla kalëfuqi,
kravata, stoli ari, fron e kuletë e gjerbë.
do të ketë njerëz që s'e dhunojnë profetin, dreqin e tokën
do të ketë njerëz që nuk ta shtrojnë tokën
për t'ju katrrisur merimangës së ëndjes.
Do të ketë njerëz që nuk fluturojnë përkrye nate
do të ketë njerëz që nuk i zë ethe shtrëngate
do të ketë njerëz që të ulen në tryezën mike
pa hile, e nuk do ta lypnin zgurrin me maje thike
do të ketë njerëz pa epoleta e medalje në kraharor
që zërin s'e qesin, po ta falin frymën këmbadorë
do të ketë njerëz në këtë tokë e nën këtë qiell
të cilët kurrë s'do ta shitnin hirin për miell.
do të ketë njerëz që s'krekesen si bibat anës lumit
do të ketë njerëz që s'i bëjnë ode përtacisë e gjumit
do të ketë martirë që ecin tokës me mua
do të ketë asi që nuk shikojnë për të shilue
do të ketë njerëz që smirës s'i bëhen therorë
do të jeni diku njerëz me ndjenja si dëborë
do të ketë njerëz të mire, o si jo: plot e përplot
po cilët janë ata, kush di të ma thotë?

TEATËR

Ec njeriu me thesin plot lule në grykë
nga i cili kundërmon era,
po ruaju se e rras dorën poshtë
- prishet aroma
e ndesh keq...
e tjera e tjera.
Mos e prish shfaqjen o ndjellakeq
aktori e bën të vetën
turma dëgjon e shikon
e kënaqur
të tillë e do jetën.
Dëgjoje, o kryeneç, këshillën e mikut:
ec rrugës symbyllas
veshëzën, i pathënë
e mos ia prish solemnitetin aktorit
dhe shengun publikut.

SHKAS

T'i gjeta xixat
të mos e humbasësh rrugën
ta kalla flakadanin
të të flakëroj fytyra
ta zbulova prushin
që të përcëllohem në te.

Prishtinë, 27.09.1979.

SHKURT

Ia urtova në sy shikimin
ia shkriva në frymë guximin
tash s'më leh dot orë e çast
unë rrugës sime - ai vjen pas.

JEHU

Ofshama ime
merr dhen
po dihatma
pështillet me erë.

Pastaj jehona
merr zërin shqim
e s'e dëgjoj as vet
rektimin tim.

Gjenevë, 14.04.1971.

RRËMUJA APO...

Të ofrojnë ëmbëlsira
e ty shpesh të dridhet dora
dhe s'di t'i qosh te goja
e sa erë u merr shqim
ta rrëmbejnë atë shujtë
sa kohë nuk ke të mendosh
se ç'ndodhi n'atë hutim.

GRYKËSI

Ta dhashë zemrën, bebëzat, damarët
të besova ma shumë se ditës së mire
t'i hapa dyer e dritare të qenies sime
vëllimet synimet e tanë fshehtësitë
t'i fala krahët që kapërthejnë largësitë
s'e dija i verbri se me kënd kam punë
s'e dija se po ushqej hienën edhe unë
e cila nesër do t'm'gëlltisi në agim
thurur kurorë e përkushtimit tim
qesh gati t'i shkrijë akullnajat me përgëzim
qesh gati me dorë t'i zbus gjembat therrake
qesh gati t'i lurtoj gjarpinjtë me shikim
qesh gati të bëhem gurrë për eliksirin e kuq
dhe tani vallë a mos shkuan të gjitha huq
çka të dhashë more e çka ruajta - vodhe
nuk di a u ngope, ç'prapsin, kur vetëm u lodhe
dora jote, nuk di çka ofron e premtion
fjala e ëmbël... po, n'kokë çka vlon?
Unë kisha të fala, ti sikur kërkon ndjesë
por, tani si, ma thuaj, si të lidhi për besë.
Mos palaços i ngjajë e kështu përditë
mirësinë e mbjellur këtë duhet pritë
e premtimet shterpa përherë do të mbesin
gjersa brinjët një ditë ta shkyejn thesin
ti han konakun dhe ndyn çanakun
unë kur me hile nuk e mora hakun
ti mirësinë time e quan verbërim
dhe si një ditë mund të vrasi afti im
se unë ty me bukë e ti mua me gurë
nuk mund të përfundoj kjo kështu kurrë.

EKSPERIMENT

Një magjistar i paemër
e gjeti barin e dritës
pastaj shkante me daltë në dorë
duke u nxjerr njerëzve sytë
për ta shporr barin e mrekullive
e për të fituar lakminë si shpëtimtar.

Prishtinë, 23.07.1986.

NJISHET

Kam marrë me u shumëzua njishat
por gjithnjë përfundim kam fitua - njëshin.
Kam marrë me u pjesëtua njëshet
e përsëri përfundim kam fitua - njëshin.
Kam provua n'katrorë njëshin me e ngritë
por njëshi neveritës prapë është përsëritë.
Kur u provua me i mbledhë njëshet
kam fitua dyshin, - kurorën e përpjekjes
dhe, ankueshëm m'janë lutë njëshet
me to - kurrë mos me e përsëritë tri veprimet e para.

XHUNGLA IME

Hape kraharorin xhungla ime e thatë
xhungla ime e egër
buzët e roshkueme ndaç me i njomë
me riga argjendi.

Të qofshim falë oj tokë
të qofshim falë o qiell
- piku rrufeja diku n' shkretinë.

Në muskujt e tërbuam të shpatullave lakuriqe
vëllait e gjakut si tubë gjarpinjsh
n' shkrumbin shtegut të ballit
djersa ndër vrushkuj rrëketë.

Hape kraharorin xhungla ime e thatë
hape kraharorin xhungla ime e egër.

A AM AME AMER

Amerika e largët e afërt
Amerika e ftoftë e ngrohtë
madhorja e madhështorja
aty secili e kishte Zotin e vet
aty secili e kishte lëkurën (ngjyrën) e vet
aty secili e kishte flamurin e vet
aty secili e kishte portin e vet
aty secili e kishte atdheun e vet
aty secili e kishte shtëpinë e vet
aty secili e kishte vetminë e vet
aty secili e kishte lumturinë e vet
aty secili e kishte harmoninë e vet.

HISTORIA E TIM AT

Tri herë mijtë braktisën hatullat
tri herë pullazi ra mbi themel.

Tri herë micat mbetën pa truall
e gjurmët i lanë nëpër hirin e vale.

Tri herë im atë, Kan Mali
pështyri duart e rroki sëpatën.

Tri herë zbardhoi pullazi i ri
u lut plaku: i mbrami qofsha fli...

Mos ia merrni për të keqe tim at
përse dëshiron ta harrojë historinë
ajo secilën herë ia ngarkoi nga një mëkat.

E ky m'uroi si prindi, me tërë dashurinë:

Ti, biro, paç rrugë e fat më të mbarë
unë shkurt e vrullshëm jetova
i thjeshtë e pa shkollë, por mësova
të jesh zot shpije, e çka kur kokën zvarrë!

Epigrame

KUPTIM

Unë kam qarë
kur keni qeshur
unë kam pare
kur shkonit zhveshur
ju atëbotë
jeni tallë
kurse sot
e keni... në ballë.

DREJTIMI

Kush i ka
tri kokrra mend
ai u shkon
punëve me rend.

KUADROT

Tash Kosova
më ka vezir,
ndoshta punët
veten më mire...

TRADITË

Mazën mua
qumështin ty,
ti përfundi
unë përmbi.
Ç'ke kujtuar
or ç'ke pritë
kam trashëgua
këtë traditë.
Kështu ish moti
e thënë nga Zoti
kur s'eci mashtrimi
u ndez baruti...

SHPËRPJESTIM

Një më shumë
erë e sqotë
kurrë më pak
Don Kishotë.

Me, 10.05.1986.

DURIMI

Koka ma dënoi dorën
gjithë sa herë
provova të përkëdhel
iriqin, mbi vullnetin
me dhëmbët e dëshirës
pre miqësie.

Me, 22.07.1986.

UNA

Një zjarrmi përherë e gjallë
është që vjen e djeg përbrenda
në veti, si llavë që kallë
por askujt dot s'ia përmenda.

Me, 29.04.1985.

LAKMI

Kurrë s'ju lëkund vreri
kurrë s'ju teratisë shikimi
kurrë s'e shitoi mallkimi
kurrë s'ju pështjellua kraharori
kurrë tufani se mori
lumi ai i lum... i mjeri.

SHTEGTIME

Si prehem kur kthej ndër ju
në të rrallë
e u sodis me mallin
që moteve më kallë.
U lëpij me shikim fytyrat
e regjura ndër shkrep
rrah rrebeshesh e erërave.
Atëbotë merr krah mejtimi
më lëbyren sytë
sa të mitë më jeni, sa jam i im
po kur u merr tufani
e më veni arsyen mbi kësulë
a shallbardhin
dhe e djeg pelini i lakmisë
në ethet e ndjellakeqes e pusisë
në hell halesh e fjalësh
- më bëheni aq të largët
e mbes vetëm pa vete pa ju
më tëhuajeni, qëndroj si hu
marr malin
atëbotë një i kam profetin e djallin.
Kur kordhni heshta helmi
e të harbuar merrni sy
në dyluftim: pas shpine a ballëpërballë
të bindur se pas jush fati u tallë
i bëri stërvajë lulet erëmira
natën e tufanit dehur nga errësira
heu, sa bonjak më leni
s'më keni dot as nuk ju kam...
pastaj i juaji as i imi nuk jam.

QENÇE (QENISHT)

Mori secili
nga një mësymje,
nga një kockë,
nga një planc,
nga një pelenë
më të madhe
- se vet...
Dhe ndukën e shnukën
krehën e shkrehën
kah stelet e veta.
E t'ia vunë sipëri
këmbë e dhëmbë,
e nisën të ngërdhucen
ndër edhe droje...

Bash njerëzisht
nisën shujtën e vet
- qenisht
rrugës kah amshimi
(s'e diti kush
ku i çeli agimi).

Pejë, 14.12.1985.

SPASTRIM...

Unë nuk jam kurrfarë magjistari
që ju e parafytyroni - doni
kot më qaseni, kot luteni e llogariteni
kot qani, kot përujeni a mitoni
shporruni që këtej
ma lironi këtë shtamë të gjorë
nuk ka vend për tërë ju
që më jeni koptisur si termitet.
Unë me rrëfimet e juaja
mbëltoj orët, netët e ditët
a bën të merrni tjetër shenj, tjetër rrugë
tjetër derë, djalli - mos u marrtë
as veshët nuk më bëjnë dot
ia nisni me fyej e sosni me tupanë
pastaj më qeponi me ç'mundeni
e më qeponi pastaj si me çekanë.
Në sy më banono, mbi supe më rëndoni
gjithkrah më shkëlni kahdo ladhoni
o mjerë unë me ju e ju me mua
jeni nisur si të shkrumbuarit
tek mendonin se buron një krua
po unë nuk jam magjistar i imagjinuar
që ua shëroj dhimbën e plagën shekullgjatë
unë se kam barin universal për lëngatat tuaja
më bluani e shtroni e gjithnjë shkallmoni
se si nuk kam dhimbje as mëshirë, nuk prani
nuk mund të më zhvishni, të më groponi...
Unë nuk jam ai që më merrni
pse kot veten e mashtroni

si udhëtar të humbur në fatamorganë.
I ngjaj tyrbes që s' i dihet martiri
as zanafilla, por ushqeni shpresë: i miri
do të na dëgjojë, lutjet, do të na mjekojë
bregash do të na shpëtoj.
O, ikni meje, mi bredhtë ato të lana kreje.
Unë nuk jam ai muri i lotëve që më merrni
bibël as kibël: po tretuni, fjalë e lot mos shterni
unë jam magjistari i rremë,
po ikni, më ngulfateni, ma lëreni një grimë
qetësi mashtruese, kaluese, një grime mashtrim.
E kemi humbur derë e të shkretën busullë
tani më gjetët të më çapiteni si bollë
ikni të mirë e të marrët e mi, shok a miq
ngopuni marri: murrizi nuk bën fiq...
Ikni në më doni
rëndë mos e paçi tokën
më fishkëllejnjë veshët, sytë më lotojnë
më kruhet trupi. Ikni ma lironi kokën
i vogël qëlloi ky kungull i gJORë
e vend nuk ngeci më as në kraharor.
Voglan vet, i lig, për dhëmbë e ju shumë
Në më besoni: frenjë i mban mendja e gjaku
ai që më merrni - u them me dinjitet
nuk jam gjykatore, jam edhe vet
gati-gati si ju i shkretë...
Kam barrë edhe unë në këtë shtegtim
mos ma ngarkoni rishtas ndonjë mundim
mos më qitni vasë, se bërtas, mund flas
e bëhet më keq: mund sharroj, mund shkllas.
S'më bën më as gurmazi - të klith
ikni, se nuk di ç'mund të bëj, mos do grith!

SHKALLËT

Në do të lidhësh rripa toke
rrjedha uji të fluturosh
e të kapërcesh dete e oqeane
nisu prej besimit prej busmit.

Në do të arrish te smoking
në do të arrish te sari
nisu nga tirqit
nisu nga xhubleta
në do të arrish te piano, te harfa
nisu nga fyelli, nisu nga lahuta.

Nisu prej atyhit
m'i lakmofsh flatrat
çdo busullë tjetër
do ta verbojë rrugën...

Prishtinë, 9.01.1986.

SOLEMNITETI “SOLO”

Kam lindur, rastësisht i vetëm
me gjasë jetoj vetëm
vetëm do të vdes, vetëm.
Heu, sa vuajta nga dashuria
desha ta përkëdhel edhe iriqin
(s'zura mend - hare e bëra viçin)
gjykuar më qenka si vetmitares shqiponjë
të katarrisem thepimeve gjithmonë
të gjezdisë vetëm, vetëm, vetëm
ndonëse kurrë s'e desha vetminë
as nuk u ngopa me pamjen time
në pasqyrën e rrumcallur...
ku e humba rrugën deri te zemrat
ku më treti rrezja prijëtare
si m'u këputen ura, zunë shtigje
ortiqet më dolën para befas
akullnajat risht ma nginë rrugën
ose zjarret ma dogjën urëligën
apo çka ndodhi me mua kësisoj!
S'e desha rolin e qyqes - kurrë
e nga më polli ky mallkim, gjykim
ta mashtroj veten si fëmijë në vetëtimë
e t'i qepem peshkut mbi shpinë
ta shiloj mjegullën ta gjerbë shiun
ëndrrat t'i tjerr kërcell saora
dhe të gjuhëm në cirkun e larmë
në rolin e aktorit fatbardhë

(Lis i ndarë në pyll - vret syrin
i tharë, ndoshta e anatemuar
që nga Zeusi e këndeje o më parë).
Tek venë rrufetë në gjumë
do të qahem e lutem për shpërlarje
mbajë fytyrën mes këmbësh
të dergjen hirësia e mirësia
të të bien dhëmbët nga rrënjët
shpirti yt në licitacion e mashtrim
e unë shkaktari i gjykuar i shënjuar
si gurë pështetur për mur
ku sprovohen shikim e tyta...

Shikoj horizontin nëpër bri dhie
s'kam vizë, hajnisht nisem me këtë anije
nis, solemniteti... secili gazmon për veti
gëzuar, për shëndetin tuaj, rrofshi e qofshi
... Jo, jo, nuk ka nevojë për njëmend
unë nuk jam vetëm, e kam plot tryezën
(në fytyrën time mos kërkoni - shend).
Për shpirt kush të pyet, për zemër, emër
kur barku është i qetësuar, i ngarkuar!
Pastaj kam edhe gjallesa të tjera përreth
që më shoqërojnë pa i diktuar ju -
plot gjallëri më shoqëron - e këndon
në korin magjik që s'e dëgjoni pa vesh:
me nga dy këmbë, dy herë më tepër, me pupla
asi që nuhasin, kafshojnë, pështyjnë helm
apo shkëlmojnë, plot kam sonte larg e afër
unë i kam edhe mizat e mija të dashura
dhe kokën e mbarsur herët me të paemrin

kam kujtime e gazmende kalimtare
e premtime, dyshime e zhgënjime.
Unë e kam plot shtëpinë e zbrazët
jo, jo njëmend nuk jam i vetëm
as i pikëlluar fare, më vjen fort mirë
pse jam kështu, pa rrotulla, sheshas
shihemi dëlirë në pasqyrën publike
kush është kush, shok apo mike...
Peng e lëmë fjalën e mbjellim farëzezën
halën, presim të dalë
shesim pastaj kërpudhat e hirit
një shale e kemi kalit e djallit
një kësulë trimaçit e martirit!
... Po ju si jeni, epo, gëzuar
unë e di, pa dyshim, keni harruar
kjo u njihet pak si rrallë
unë rreth qiririt sillem sa vërdallë
pa gjë në kokë pa sy në ballë
asgjë s'më shuan, më asgjë s'më ndalë.
Jam meteorologu herak që shqetëson gotën
e pi me vije të agimit, para zgjimit
nga dylbitë magjike e sogjoj vet botën...
Pastaj s'u kam frikën rrebesheve
mund të heq valle me trubadurët e ferrit
që rrisin dhëmbët e shkukur
me lyhen me dhjam historie të kaptuar
për t'u ngritur veprash të përrallave
ku darkojnë lakmitë e ndërsyera...
Gëzuar, mos ma bani dertin, s'jam vetëm
plot kokën e kam, tryezën, odën
plot galerinë që s'e njihni, s'e shihni

po ta zbrazja këtu para jush
do të merrnit mal e fushë nga frikësimi
nga hutimet e ushtarëve të mijë të butë
që janë dehur lodrash e përrallash, kopallash
ata dordalecat e fëmijërisë mbajtur
në shpellat e mija të mira prej mjegulle
në kullat prej tallash...
Jo, jo, vetëm nuk jam, luani vallëzoni
ju lutem... gëzuar, gëzuar, mos u trazoni
hani e pini e këndonit e këndonit...
praninë time s'keni pse ta hetoni
keni gostinë... shi - siç e doni.

Makarskë, 8 maj 1987.

PËRMBAJTJA:

FARËMBARË	8
<i>Sa për dijeni...!</i>	9
1957 – 1972.	11
ARTISTIT	13
N A	15
TREGIM I TË VERBTIT	16
PRITJE	17
SONTE	18
AKULLNAJET	19
RRASHTA E DENUEME	20
KËRCNIM	22
ANDËRR	23
ZOG ZJARRI	24
ZHGËNJIM	26
KËSHILLA	27
NË MUA	28
KUSHT	29
ME NJERËZ	30
T'ISHA	31
PREJ ZEMRE NË ZEMËR	32
PYETJE	33
EMNIM	35
HISTORIA E U.S.	36
VETËM URA	37
HIJE HINI	38
ORTEKU	39
KUR TË VDES UNË	40
TREGTARI	41
FILLIMI	42
MASHTRIA	43

MOS ME TË PASË TY	44
TI.....	45
SMIRË LAKMI	46
BUKURITË E SHËMTUARA.....	47
DOLLIA	48
LISIT	49
FENIKSI I RI.....	50
MASKARADA.....	53
SHIU, SHIU, SHIU.....	54
PREMTIMI.....	55
RITAKIM	56
FJALËKRYQI	57
BETOHEM.....	58
E KREMTE ËSHTË.....	59
ECIM.....	60
TRADHËTI	61
PO KRIJOJ... PO NDËRTOJ	62
DRUA, DAMARËVE TANË.....	65
KEPI I FATIT TË KEQ	67
HIJE NATE	68
KTI I THEM MJEGULLA.....	69
GJOLI.....	70
KORIDA.....	71
DUELI	72
PASQYRË	73
THONË	74
NDODHI	75
PADIJA E HIJEVE.....	76
NJË NXANËS:	79
NJË PESHKATAR	81
NJË FOSHNIJE	83
LOJA E LUGETËRVE	84

GATI.....	85
PA STROFULL.....	86
MOTËRZIM.....	87
ULKOJA.....	88
QETËSI!.....	89
NUK JE VETËM.....	90
URTIA.....	91
NDARJE.....	92
GËZIMI I GËZIMIT.....	93
ÇAST DËLIRSIJE.....	94
AS TI.....	95
1975 – 1999.....	97
SI.....	99
DJE DHE SOT.....	100
PERFTIMUR.....	101
PËRRALLË TERRI.....	102
VIZA IME.....	103
ËSHTË... E S’ ËSHTË.....	104
VETËM, GURË.....	106
KURGJË NUK MORI TOKA.....	107
NËSE.....	108
SHTEGTIM.....	109
ELEGJIKE.....	110
LAKMI.....	111
RROTULL.....	112
KOT U BETOVA.....	113
BARRË E MARRË.....	114
ASGJË ME HIJENËN.....	115
ARRATIA.....	116
DASH DRAGOI.....	117
KUT E QYP.....	118
GURË I VAKTË.....	119

MOS...MOS.....	120
MALL.....	121
KOMETA IME.....	123
TRASHËGIMIA.....	124
ÇAST (REÇETË).....	125
DHJETË ME NJË.....	126
NDËRSIM.....	127
NJOFTIM.....	129
DALLIM.....	130
BAJRYMERAJT.....	131
UNË ECI VERTIKALISHT.....	134
PLAGA IME - KOSOVË.....	135
MANIFESTI IM.....	136
PIKNIK GURI.....	138
PRE E PREMTUAR.....	140
THONI I NXIRË - ILAÇ.....	142
GJELAS.....	143
GJOLI.....	144
LUTEKOTE.....	145
TRESHI.....	146
DALLGA.....	147
BETIMI.....	148
SOLO.....	149
ERË DHEU.....	150
GADISHULL.....	156
UJËVARJA E UJKANIT.....	157
DUET(I).....	158
KROMA.....	159
SPASTRIM.....	160
RRËFIMI IM.....	162
GANGRENË.....	164
VIGJILENT.....	165

BIMË E TRUA	166
KAPTIM.....	167
REPRIZË	168
EH	169
DIKTAT	170
DRY	171
DISONANCË	172
MIRËNJOHJE	173
FAKIR.....	174
UNË RRITEM NË GOTË.....	175
DITARI	176
XIXA.....	177
Fall	178
KUMTI.....	179
ADRESË E GABUAR	180
TJETËR RRUGË	181
PAJTIM	182
LUTJE SUPTILE.....	183
NGRITE KOKËN.....	184
HYMNI DIELLOR (qiellor)	188
AMNESTIM.....	190
AGTERRI.....	192
VDEKJA E POETIT	194
URDHËRORE	195
BESNIK BJESHKA.....	197
LICITACION	199
LEHONË	200
STAFETË	201
BOSHTI.....	203
EPIGRAME.....	204
EKULIBER	206
TERRAQ	207

POSTKRIPTUM.....	209
MAGJIA E MASHTRIMIT	210
UDHËTARI.....	211
HAPAT E M I.....	212
DREDHË.....	214
KËRCËNIM, MONOLOG, AUTOKËRCËNIM	215
VESË E DETË.....	218
STREMI	220
REPRIZA	221
KOTËSI - VIZË.....	222
RECUIEM PËR NE	223
USHQIME	225
Ku.....	226
SHQETËSIMI I SHQIPONJËS.....	227
ADRESARI I VJETËR	228
ÇELËSAT (AJRI).....	229
FAT FUTURE	230
MERSI, HYSEN.....	231
SHUJTË KRIMBASH	232
SHTEGTARË.....	233
KËRKIM	234
DON KISHOTI.....	235
TEATËR.....	236
SHKAS	237
SHKURT	238
JEHU	239
RRËMUJA APO.....	240
GRYKËSI.....	240
EKSPERIMENT	242
NJISHET	243
XHUNGLA IME	244
A AM AME AMER.....	245

HISTORIA E TIM AT	246
Epigrame.....	247
KUPTIM.....	247
D R E J T I M I	247
KUADROT.....	247
TRADITË	248
SHPËRPJESTIM	248
DURIMI	249
UNA	249
LAKMI.....	249
SHTEGTIME.....	250
QENÇE (QENISHT).....	251
SPASTRIM.....	252
SHKALLËT.....	254
SOLEMNITETI “SOLO”	255

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1-82

Shkreli, Adem

Dritëhijet e jetës : nga dorëshkrimet e vjetra 1957-2003 : autentike me gjuhë dhe koherencë kur janë shkruar : poezi / Adem Shkreli. - Prishtinë : IWA Bogdani, 2024. - 266 f. ; 20 cm. - (Biblioteka ”Adem Shkreli”)

ISBN 978-9951-394-29-1